

1 E hënë, 9 tetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 08.59

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e Gjykatës, paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
8 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kujtoj palët
11 se për shkak se ka pasë një ndryshim në programimin për ditën
12 e sotme, nuk do kemi seancë të tretë sot dhe të enjten,
13 domethënë, seanca sot dhe të enjten do të mbyllet në orën 1.00
14 të drekës.

15 Vërej se ka një çështje për 13 shtatorin 2023. Është një
16 e lidhur me transkriptin që do ta trajtoj Trupi Gjykses para
17 se të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 03880.

18 Trupi Gjykses kujton se më 11 dhe 13 shtator 2023,
19 Dëshmitari 0483807 dha dëshmi para Trupit Gjykses.

20 Më 11 shtator, Trupi Gjykses pranoi deklaratat e
21 Dëshmitarit 3827 në përputhje me rregullën 143(2).

22 Në 13 shtator, Mbrojtja e Veselit vërejti se parashtimet
23 ligjore në lidhje me këtë çështje ishin bërë në seancë private
24 dhe kërkoi që transkripti të klasifikohet si publik. Trupi
25 Gjykses Urdhëroi ZPS-në të propozonte redaktime nëse ishte

1 nevoja dhe këtë ta bënte me shkrim.

2 Më 15 shtator 2023, ZPS-ja dorëzoi redaktimet e
3 propozuara. Mbrojtja dha redaktime alternative.

4 Duke pasur parasysh parashtrimet e palëve, Trupi Gjykses
5 miraton kërkesën për redaktime të propozuara në faqen 7973,
6 rreshti 6 dhe rrezon redaktimet e tjera.

7 Trupi Gjykses, po ashtu, urdhëron riklasifikimin e
8 materialit si publik, e shtjelluar kjo në parashtrimet e
9 palëve dhe në përputhje me rregullën 143(2) e bërë konkretisht
10 më 13 shtator 2023, e reflektuar në faqen 7946 të
11 transkriptit, rreshti 11 dhe faqja 7977, rreshti 17.

12 Me kaq mbyll urdhrin me gojë të Trupit Gjykses.

13 Vërej se të akuzuarit janë të gjithë të pranishëm në
14 sallën e gjyqit. Dhe ne do të fillojmë me dëshminë e
15 Dëshmitarit të Prokurorisë, Dëshmitari me numër 03880. Jemi në
16 seancë publike.

17 I lutem Asistentes, të sjellë dëshmitarin në sallën e
18 gjyqit.

19 Sa kohë kërkon Prokuroria për pyetjet? E njëjta?

20 Z. BOYLE: [Përkthim] E njëjta që kishim kërkuar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndryshim
22 nga Ekipet e Mbrojtjes sa i takon përlllogaritjes kohore?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ka të ngjarë që më pak se
25 ç'kishim parashikuar fillimisht, po të shohim si do të jenë

1 zhvillimet.

2 Z. TULLY: [Përkthim] Ju njoftova javën e kaluar që ne nga
3 një orë e gjysëm që kishim kërkuar fillimisht, kërkojmë vetëm
4 gjysëm ore.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Ka të ngjarë që do na nevojitet më
6 pak se ç'kishim kërkuar fillimisht, po të shohim si do të jenë
7 zhvillimet dhe do t'ju njoftojmë.

8 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] mirëmëngjes,
10 Dëshmitar. A më dëgjoni?

11 DËSHMITARI:[Përkthim] Po. Mirëmëngjes, të gjithëve.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistentja do
13 t'ju japi tekstin për deklaratën solemne të cilën duhet ta
14 merrni në përputhje me rregulloren tonë. Ju lutem, shihni
15 dokumentin, lexojeni me zë të lartë më pas.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
17 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
18 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
19 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
20 cilën kam dijeni.

21 DËSHMITARI: W03880

22 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
24 sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që pritet të zgjasë rreth
25 nëntë orë. Sikurse mund ta dini, fillimisht do t'jua bëjë

1 pyetjet Prokuroria. Pasi të mbarojnë Ekipet e Mbrojtjes kanë
2 të drejtë t'ju bëjnë pyetje. Si dhe Gjykatësit e Trupit
3 Gjykues mund t'ju bëjnë pyetje.

4 Prokuroria parashikon një orë e gjysëm për t'i bërë
5 pyetjet. Mbrojtja parashikon shtatë orë. Shpresoj që palët të
6 jenë të kujdesshëm sa i takon përdorimit të kohës. Trupi
7 Gjykues mund të lejojë pyetje shtesë nëse përmbushen kushtet
8 përkatëse.

9 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni pyetjeve qartë me fjali
10 të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkojini
11 folësit që ta përsërisë pyetjen ose thjesht thoni që nuk e
12 kuptoni dhe ata do ta sqarojnë për ju. Gjithashtu, na thoni ku
13 i bazoni njohurinë, faktet dhe rrethanat për të cilat do të
14 jepni përgjigje.

15 Në rast se ju kërkon ZPS-ja të flisni për korrigjimet që
16 keni bërë në deklaratën tuaj, ju kërkojmë që për procesverbal
17 të thoni me zë që deklarata me shkrim ka reflektuar
18 korrigjimet tuaja dhe reflekton saktësisht deklaratën tuaj.

19 Gjithashtu flisni para mikrofonit dhe prisni pesë sekonda
20 para se të përgjigjeni, flisni ngadalë në mënyrë që dhe
21 përkthyesit t'ju ndjekin.

22 Në qoftë se nuk e mbarojmë dëshminë tuaj sot, ju lutem,
23 kini parasysh që nuk duhet ta diskutoni përmbajtjen e dëshmisë
24 suaj jashtë mureve të sallës së gjyqit me askënd derisa të
25 keni përfunduar tërësisht me dëshminë tuaj. Në qoftë se dikush

Dëshmitari: W03880 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Boyle

Page 5

1 jashtë sallës së gjyqit ju pyet lidhur me dëshminë tuaj, ju
2 lutem na njoftoni.

3 Mos flisni nëse unë ngre dorën ose ju kërkoj të mos e
4 bëni, sepse kjo do të thotë që unë do të jap një udhëzim të
5 mëtejshëm. Nëse keni nevojë për pushim na bëni me dijeni dhe
6 ne do t'ua plotësojmë këtë kërkesë?

7 A i kuptoni këto?

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. Në rregull.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Tani fillojmë me pyetjet e Prokurorisë. Janë
11 përfaqësuesit këtu, që do t'ju bëjnë pyetje.

12 Pyetje nga z. Boyle:

13 Z. BOYLE: [Përkthim]

14 PY. Mirëmengjes, Dëshmitar. Ne jemi takuar dhe më përpara, po
15 unë do prezantohem përsëri. Unë jam Andrew Boyle. Jam këtu për
16 llogari të Zyrës së Prokurorisë dhe do ju bëj pyetje për një
17 orë e gjysmë.

18 Sikurse ju shpjegova gjatë seancës përgatitore, pra, siç
19 ju shpjegova gjatë seancës përgatitore që patëm para sisa
20 ditësh, në vend që t'ua bëjmë pyetje për çdo aspekt të mundshëm
21 për të cilat mund të keni informacion, mund të jetë e mundur
22 që të pranojmë disa nga deklaratat e tua të mëparshme si prova
23 ku janë këto dëshmi. Po për ta bërë këtë, duhet të ndjekim
24 disa hapa proceduralë që do t'ua shpjegoj pasi të përfundojmë
25 me të dhënat tuaja identifikuese.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Boyle

Faqe 6

1 Z. Dëshmitar, a mund të na thoni emrin dhe mbiemrin?

2 PË. Nebojsa Radosevic. Nebojsa Radosevic. Emri im është
3 Nebojsa Radosevic.

4 PY. Z. Radosevic, kur keni lindur?

5 PË. 17 shtator 1966.

6 PY. Çfarë kombësie keni?

7 PË. Malazez, po jam shtetas serb. Zakonisht në formularë e
8 shkruaj që jam me kombësi malazeze, po jam shtetas serb.

9 PY. E kuptoj.

10 Z. BOYLE: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës, që
11 të shfaqë në ekran materialin 070725-TR Pjesa 1 RED2, ndërsa
12 në serbisht është 070725-TR Pjesa 1 RED.

13 PY. Z. Radosevic, a e shihni dokumentin e shfaqur në ekranin
14 tuaj?

15 PË. Po.

16 PY. Ky dokument është pjesa e parë e një interviste që keni
17 pasur me ZPS-në në dhjetor të 2019. A ju kujtohet të jeni
18 takuar me përfaqësues të Prokurorisë në dhjetor të 2019 dhe
19 ata ju kanë bërë pyetje çfarë ju ka ndodhur personalisht dhe
20 të tjerëve në vitin 1998?

21 PË. Po, në rregull.

22 Z. BOYLE: [Përkthim] I lutem Sekretares, të shfaqë në
23 ekran materialin SPOE000788102 deri në SPOE0078818-ST E
24 Rishikuar RED.

25 PY. Z. Radosevic, e shihni dokumentin në ekran?

1 PË. Po

2 PY. Kjo është një deklaratë që ju ka marrë policia e EULEX-it
3 më 19 prill të 2011. A ju kujtohet të jeni takuar me policinë
4 e EULEX-it në 2011 dhe ju bënë pyetje ata për ato që ju kanë
5 ndodhur ju në vitin 1998?

6 PË. Po.

7 Z. BOYLE: [Përkthim] I lutem Sekretares, të shfaqë në
8 ekran SITF00009201-00009206 RED2 në faqen 00009206. Përkthimi
9 në serbisht është me të njëjtin numër thjesht ka një -ST RED.
10 PY. Z. Radosevic, a e shihni dokumentin në ekran?

11 PË. Po, në rregull.

12 PY. Kjo është një dëshmi që i keni dhënë Zyrës së Prokurorit
13 të Specializuar të Republikës së Kosovës në janar të 2012.

14 Z. BOYLE: [Përkthim] I lutem Sekretares, të shkojmë në
15 faqen e -- jo, jemi në faqen e fundit.

16 PY. Z. Radosevic, a e shihni emrin tuaj në fund të faqes në
17 të majtë?

18 PË. Po, është e shkruar.

19 PY. Nënshkrimi juaj është ky?

20 PË. Po. Po, këtu po.

21 PY. A është e saktë që jeni takuar me përfaqësues të Zyrës së
22 Prokurorit të Specializuar të Republikës së Kosovës në 2012
23 dhe ata ju kanë bërë pyetjet se çfarë ju ka ndodhur ju në
24 1998?

25 PË. Po.

1 PY. Z. Radosevic, a ju kujtohet që para disa ditësh i

2 rilexuat këto deklaratata?

3 PË. Po.

4 PY. A ju kujtohet që ju dhashë dhe mundësinë që të bënit

5 sqarime lidhur me këto deklaratata?

6 PË. Po.

7 PY. A ju kujtohet që bëtë një sërë sqarimesh lidhur me

8 deklaratat tuaja të mëparshme?

9 PË. Po.

10 PY. A ju kujtohet që këto sqarimet dhe korrigjimet u hodhën

11 në një korrigjim që ua lexuam sërish juve?

12 PË. Po.

13 PY. Duke marrë parasysh korrigjimet që lexuam tek ai shënim

14 bashkë me këto korrigjimet, informacioni në dokumentet që ju

15 tregova sot është i saktë dhe i vërtetë me aq sa besoni dhe

16 mendoni ju?

17 PË. Po, i saktë. Me aq sa di dhe aq sa besoj.

18 PY. Duke marrë parasysh korrigjimet në shënim, dokumentet që

19 ju tregova sot a reflektojnë saktësisht të njëjtën gjë që do

20 të thonit sot nëse do ju bënin pyetje për ngjarjet?

21 PË. Po, po. Kështu.

22 Z. BOYLE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin

23 e deklaratave të mëparshme që përmenda më herët dhe do të doja

24 që anglishtja, shqipja dhe serbishtja të pranohen. Numrat e

25 ERN-ve janë 070725-TR-ET Pjesa 1 RED2 dhe Pjesa 2 dhe 3. Në

1 serbisht është 070725-TR Pjesa 1 RED dhe Pjesa 2 dhe 3. Në
2 shqip 070725-TR-AT Pjesa 1 RED2 dhe Pjesët 2 dhe 3.

3 Deklarata tjetër ka numrin SPOE00078810-00078819 RED në
4 anglisht. Në serbisht SPOE00078810-SPOE00078818-ST E Rishikuar
5 RED. Në shqip ka të njëjtin numër -- ju kërkoj ndjesë, vetëm
6 në fund numri është 78819-AT RED.

7 Dhe deklarata e fundit ka numrin SITF00009201-00009206
8 RED2 anglishtja. Në serbisht SITF00009201-00009206-ST RED. Në
9 shqip SITF00009201-SITF00009206-ST RED2 në shqip.

10 Si kurse përcaktohet në mocionin sipas rregullit 154 për
11 këtë dëshmitar, kërkoj që të pranohen dhe provat materiale
12 bashkëshoqëruese të këtyre deklaratave. Numri i parë është
13 070724-070724-ET, e njëjta gjë dhe shqipja po thjesht që
14 mbaron me AT në fund. Dhe dokumenti i dytë është U003-8552-
15 U003-8690 në U003-8645-U003-8645, e njëjta gjë dhe shqip por
16 AT në fund.

17 Kërkoj edhe pranimin e shënimit përgatitor që mban numrin
18 116022 dhe 116028, ku janë përfshirë dhe sqarimet që bëri
19 dëshmitari gjatë seancës përgatitore në përputhje me
20 deklaratat e propozuara sipas rregullës 154.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
22 çaktivizuar].

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne kemi pak vështirësi me deklaratën
24 e 2011-s. Nëse shohim intervistën e ZPS-së, pra, lidhur me
25 deklaratën e 2011 dhe po lexoj 070725-ET Pjesa 1, faqja 8,

1 rreshtat 1 deri në 24.

2 Së pari, dëshmitarit nuk i kujtohet ta ketë dhënë
3 dëshmitarin [sipas përkthimit]. Së dyti, dëshmitari, nuk e ka
4 nënshkruar asnjëherë deklaratën. Dhe ZPS-ja i kërkon Trupit
5 Gjykues të flitet për saktësinë e një interviste që vetë
6 dëshmitari ka thënë që reporteri i Tanjug-ut që pretendohet se
7 ishte atje, por dëshmitarit i kujtohet se nuk ka qenë atje.
8 Pra, kjo vë në pikëpyetje saktësinë e kësaj deklarate. Dhe jam
9 pak i paqartë tani sepse Prokurori po kërkon që të pranohet
10 një deklaratë për llogari të një dëshmitari dhe ky dëshmitar
11 nuk pajtohet me këtë, të paktën pjesërisht dhe dëshmitari nuk
12 e ka nënshkruar këtë deklaratë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Emmerson, keni gjë për të thënë?

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Jo.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Asgjë për të shtuar.

18 Z. BOYLE: [Përkthim] Më lejoni të kundërpërgjigjem

19 shkurtimisht, të nderuar Gjykatës?

20 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
22 çaktivizuar].

23 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit.

24 Mendoj se Avokati tha që dëshmitarit nuk i kujtohet që
25 gazetari të ketë qenë atje, por është Avokati që tha që nuk më

1 kujtohet të ketë qenë atje. Por nuk mund të thuash që nuk i
2 kujtohet deklarata. Sepse, nëse shohim pjesën e parë të
3 intervistës së ZPS-së, konkretisht faqet 8 dhe 9, ai qartë
4 thotë që i kujtohet se e ka dhënë këtë intervistë dhe e
5 kundërshton faktin që Avokati që pretendohet se ka qenë atje,
6 të ketë qenë në të vërtetë atje.

7 Dhe ndonëse ai nuk pajtohet nga disa nga përmbajtjet e
8 asaj deklarate, i është dhënë mundësia ama edhe përmes
9 deklaratës së ZPS-së, por edhe në seancat përgatitore t'i
10 sqaronte këto gjëra që ishin të paqarta.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Më lejoni t'u përgjigjem, i nderuar
12 Gjykatës?

13 Unë fola dhe për intervistën e ZPS-së në vetvete, ka të
14 njëjtin numër ERN thashë, faqja 8, rreshti 1 deri në 24, ai
15 thotë:

16 "Po ju them që nuk më kujtohet kjo deklaratë".

17 Shkojmë në faqen tjetër. Po me ERN 070725-TR-ET Pjesa 1,
18 rreshtat 4 deri në 20, ZPS-ja i thotë:

19 "A ju kujtohet në ç'mënyrë Avokati i Tanjug-ut mori pjesë
20 në intervistën në Beograd?"

21 Përgjigje:

22 "Do të doja t'jua theksoja dhe njëherë, ai person nuk ka
23 qenë fare atje".

24 Pra, ky dëshmitar nuk e ka nënshkruar dokumentin.

25 Qartësisht ka probleme me citimin që i është bërë në këtë

1 dokument sa i takon faktit që ka qenë Avokati i Tanjug-ut
2 atje. Po përsëris edhe njëherë dhe po pyes, si mund të kërkojë
3 deklaratë ZPS-ja të pranohet vërtetësia e një dokumenti për të
4 cilin vetë dëshmitari ka kundërshtime kur thotë që nuk ka qenë
5 një avokat, një ndër gjërat që ka probleme.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne e kemi
7 vendosur këtë çështje në vendimin sipas rregullës 154. Është
8 bërë një konfirmim i duhur i saj dhe ne do t'i pranojmë
9 dokumentet që u përmendën në anglisht, në shqip dhe në
10 serbisht, si dhe shënimin përgatitor dhe do t'u japim të
11 gjithëve numrin e provave materiale.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata e parë 070725
13 Pjesa 1 merr numrin e provës materiale P488.1, të njëjtin
14 numër merr dhe shqipja edhe serbishtja. Pjesa 2 e 070725 merr
15 numrin e provës materiale 488.2. Pjesa e tretë merr numrin e
16 provës materiale P488.3.

17 Dhe deklarata e radhës, SPOE00078810 deri në
18 SPOE00078819, të tre versionet, serbisht, anglisht dhe shqip,
19 marrin numrin e provës materiale P489.

20 Materiali SITF00009201 deri në 00009206 dhe përkthimet
21 përkatëse në serbisht dhe në shqip marrin numrin e provës
22 materiale P490.

23 Provat materiale shoqëruese me numër 070724 deri në
24 070724-ET dhe AT marrin numrin e provës materiale P491.

25 Materiali U003-8552 deri në U003-8690 në faqen U003-8645

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Boyle

Faqe 13

1 deri në U003-8645 bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe marrin
2 numrin e provës materiale P492.

3 Dhe, në fund, shënimi përgatitor, me numër ERN 116022
4 deri në 116028 merr numrin e provës materiale P493.

5 Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 Sekretare.

8 Mund të vazhdoni.

9 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit.

10 Më 6 tetor, ZPS-ja qarkulloi një përmbledhje e propozuar
11 të këtij dëshmitari që tashmë është pranuar sipas rregullës
12 154 për Trupin Gjykes, për Ekipet e Mbrojtjes dhe për
13 Mbrojtësin e Viktimave. Nuk është paraqitur asnjë kundërshtim
14 lidhur me këtë përmbledhje, prandaj para se të filloj me
15 pyetjet shtesë që kam, do të bëjë një përmbledhje të shkurtër
16 të deklaratave të z. Radosevic tashmë janë pranuar si prova.

17 Z. Radosevic, ka qenë gazetar i Tanjug-ut që në fillim të
18 1996. Më 18 tetor 1998, po udhëtonte me një automjet me një
19 fotograf të Tanjug-ut i quajtur Vladimir Dobricic dhe u ndalua
20 në një pikë kontrolli të UÇK-së. Janë mbajtur të ndaluar në
21 katër vende për një periudhë kohore 41 ditore përfshirë dhe
22 një vend në Sedllarë, ajo që z. Radosevic beson që është
23 Kleçkë.

24 Z. Radosevic, është mbajtur i ndaluar në Sedllarë dhe
25 gjatë kohe një anëtar i UÇK-së i ka vendosur një armë në gojë

1 dhe i ka thënë të identifikohet me logon e UÇK-së -- dhe ai
2 kishte logon e UÇK-së dhe fliste shqip.

3 Gjatë kohës që është mbajtur i ndaluar në Kleçkë, z.
4 Radosevic është kërcënuar me thikë. Edhe gjatë kësaj kohe ai
5 dëgjonte dy policë serbë që bërtisnin sepse po i rrihnin.

6 Z. Radosevic dhe z. Doricic janë dënuar sepse kanë
7 udhëtuar në territorin e UÇK-së pa leje dhe pa një identifikim
8 që ishin anëtarë të shtypit në automjetin e tyre dhe u dënuan
9 me 60 ditë burgim. Z. Radosevic thotë që nuk ju është dhënë
10 mundësia të flasë gjatë procesit gjyqësor ku u mor edhe dënimi
11 i tyre. Z. Radosevic dhe z. Dobricic u liruan më 27 nëntor
12 1998 dhe ju thanë që ju ishte dhënë amnisti me rastin e Ditës
13 së Flamurit.

14 PY. Z. Radosevic, në deklaratën ZPS-së që sapo është pranuar
15 deklaruar që kishit dhënë një intervistë në vitin 2018 një
16 portali që quhet Vice. A të kujtohet?

17 PË. Duhet të jetë për vitin 2018, intervista që kam dhënë në
18 Vice.

19 PY. Kërkoj ndjesë nëse e thashë gabim vitin. Por 2018 e kisha
20 fjalën, për 2018.

21 PË. Dakord. Sigurisht që unë i dhashë një intervistë Vice,
22 pikërisht një mikut tim dhe e kam dorëzuar këtë deklaratë.

23 Z. BOYLE: [Përkthim] Sekretaria, ju lutem të vendosim në
24 ekran 114275 deri në 114289. Ka të njëjtën shifër dhe në
25 anglisht vetëm se në përfundim ka ET.

1 PY. Z. Radosevic, në ekran keni një dokument që vjen
2 vice.com, ku thotë që "Isha i ndaluar nga UÇK-ja për 41 ditë
3 me radhë". A të kujtohet nëse kjo është intervista që ju keni
4 dhënë revistës Vice?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe a mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues se cilat janë
7 rrethanat në të cilat e keni dhënë këtë intervistë për
8 revistën Vice?

9 PË. Më vjen keq, po nuk e kuptoj pyetjen që keni bërë, po më
10 lejoni të them atë që mund të them. Ishim ulur në një kafe.
11 Jashtë ndërtesës së Tanjug-ut dhe ai më pyeti nëse isha i
12 gatshëm t'i jepja një intervistë. Kjo është përgjigja ndaj
13 pyetjes suaj për rrethanat në të cilat unë e dhashë
14 intervistën? Pra, ky i ri më kërkoi t'i jepja një intervistë.
15 Dolëm nga ndërtesa. U ulëm aty dhe unë dhashë intervistën. Nuk
16 di se çfarë të them tjetër.

17 PY. Mjafton. Faleminderit. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues
18 se çfarë keni diskutuar gjatë kësaj interviste?

19 PË. Kishte të bënte me përvojën time gjatë atyre 41 ditëve.
20 Ne e njihnim njeri-tjetrin që prej kohësh. Edhe ai ishte në
21 Prishtinë në vitin 1998, 1999. Në atë kohë më duket se punonte
22 për B92 apo diçka të ngjashme, po kjo s'ka rëndësi. Por e kemi
23 njohur njeri-tjetrin. Më pas jemi takuar në Beograd dhe më
24 kërkoi që të jepja intervistë. Nuk e di arsyen. Besoj që zyra
25 për të cilën ai tashmë punonte mendonte se ishte diçka

1 interesante. Dhe atij i thashë të njëjtën gjë që ju kam thënë
2 edhe juve. Kaq.

3 PY. A diskutuat në atë intervistë sesi ju kanë mbajtur të
4 ndaluar, ndalimin tuaj, z. Dobricic, trajtimin që ju kanë bërë
5 dhe më pas lirim?

6 PË. Në fakt këto ishin gjërat e vetme për të cilat kemi
7 biseduar. Siç mund të shihet, në këtë pjesë të intervistës,
8 unë i thashë atij se ç'na kishte ndodhur, si u lirua dhe më
9 pas biseduam edhe gjëra rutinore "Si je?", "Si shkon", e
10 kështu me radhë. Por në përgjithësi për këtë çështje kemi
11 folur.

12 Z. BOYLE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
13 pranohet si provë ky material.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] nuk kam kundërshtime.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 114275 deri
18 në 289 do të pranohet si provë materiale dhe do t'i jepet një
19 provë materiale e Prokurorisë.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
21 këtë numrin e provës P494.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Z. BOYLE: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Z. Radosevic, në deklaratën tuaj, që u pranua si provë
25 para ca minutash, ju thatë që pasi ju ndaluan ju thanë që juve

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Boyle

Faqe 17

1 po ju hetonin me akuzën e spiunimit dhe ju dhe z. Dobricic më
2 pas u njoftuat se ishin dënuar se kishit udhëtuar në territor
3 të UÇK-së pa leje dhe nuk kishit shenjën që i përkisnit
4 shtypit në makinën tuaj dhe ju kanë dënuar me 60 ditë burg. Do
5 t'ju bëj disa pyetje.

6 A mund t'i tregoni Trupit Gjykues që gjatë kohës që jeni
7 ndaluar në Shalë a ju kanë mbajtur të ndaluar në të njëjtën
8 dhomë bashkë me z. Dobricic apo në dhoma të veçanta?

9 PË. Po ndaloj për shkak se i nderuar Gjykatës më tha që të
10 ndaloja, të bëja pak pauzë përpara se t'ju përgjigjesha. Në
11 dhjetë ditët e para unë isha në një dhomë të veçantë nga z.
12 Dobricic, 10 apo 11 ditë. Pra, më lejoni të shpjegoj. Kjo
13 ishte një si zyrë mjeku aty. Kishte një frigorifer. Kishte
14 pajisje dentare. Kishte disa fotografi nëpër mure, siç ka në
15 zyrat e mjekëve zakonisht. Unë isha në një dhomë, ndërkohë që
16 z. Dobricic ishte në një dhomë tjetër, në një dhomë më të
17 madhe, ndoshta ishte dhoma e pritjes. Pas 10 apo 11 ditësh, ne
18 shkuan në të njëjtën dhomë, në dhomën ku ishte z. Dobricic.
19 Dakord?

20 PY. Po. Dhe pasi që ju vendosën në të njëjtën dhomë në Shalë,
21 a keni qëndruar të dy së bashku gjatë gjithë kohës deri në
22 lirim tuaj?

23 PË. Po, në 30 apo 31 ditën që kanë mbetur. Pra, një ditë më
24 shumë apo më pak, ne ishin së bashku. Nga në Shalë nga kur më
25 nxorën nga dhoma ime dhe më vendosën në dhomën e Dobricic ne

1 kemi qëndruar së bashku gjatë gjithë kohës.

2 PY. Dhe pasi që ju ishit së bashku a keni diskutuar njeri me
3 tjetrin se çfarë u kishte ndodhur juve kur ishit mbajtur të
4 ndaluar veçmas gjatë asaj periudhe dhjetë ditore?

5 PË. Po, patjetër.

6 PY. Dhe a e pyetët z. Dobricic nëse e kishte marrë UÇK-ja në
7 pyetje?

8 PË. Po. Patjetër që e pyeta nëse kishin shkuar në dhomën e
9 tij. Dhe tha që kishin ardhur katër apo pesë persona. Në fakt,
10 të njëjtët persona të cilët kanë ardhur edhe në dhomën time.
11 Së pari shkuan te dhoma e tij dhe më pas, gjatë së njëjtës
12 ditë, erdhën edhe në dhomën time.

13 PY. Dhe a e pyete sesa herë e kishin marrë në pyetje?

14 PË. Ai më foli për një rast në të njëjtën moment kur na kanë
15 marrë në pyetje të dyve. Më duket se ka zgjatur rreth 10
16 minuta, siç ju kam thënë më përpara. Ndoshta ishin u çuditën
17 me mua sepse unë vija nga Prishtina. Nuk e di. Kështu që më
18 pyetën mua për një periudhë rreth gjysëm ore deri në 40
19 minuta, ndërkohë që atë e kanë marrë në pyetje për një
20 periudhë më të shkurtër.

21 Pra, si përmbledhje mund të them që me Dobricic kanë
22 kaluar rreth 10 minuta. Ndërsa me mua 30 deri në 40 minuta.

23 PY. A ju keni treguar lidhur me tematikën për çfarë e kanë
24 marrë në pyetje?

25 PË. Ai tha pak a shumë atë që thatë ju apo që thashë unë më

1 herët. Që ishte informuar që ishim akuzuar për spiunazh për
2 shkak se nuk e kishim në dokument një shenjë identifikuese që
3 i përkisnim shtypit. Kur erdhën në dhomën time, diskutuam për
4 gjëra të ndryshme, folëm për situatën politike, çfarë po u
5 bënte Miloseviçi shqiptarëve, çfarë po i bënin serbët
6 shqiptarëve. Pra, në përgjithësi bëhej fjalë për çështje
7 politike, për atë që Miloseviçi po u bënte shqiptarëve dhe e
8 njëjta gjë ka ndodhur edhe me mua.

9 Mund të vazhdoj nëse dëshironi ose ta ndaloj. Si të doni
10 juve

11 PY. A keni dijeni lidhur me ndonjë gjë tjetër përveç
12 aspekteve politike për të cilët i kanë marrë në pyetje z.
13 Dobricic dhe juve vetë, nëse po, vazhdoni.

14 PË. Dakord. Nuk e di nëse e kanë pyetur z. Dobricic për
15 ndonjë gjë të ndryshme nga ajo që ju kam thënë deri tashmë. I
16 kanë thënë për çfarë ishte akuzuar. Kanë diskutuar situatën
17 politike në vija të përgjithshme kaq. Këtë më tha. Dhe më pas
18 kemi biseduar për çështje të ndryshme.

19 Unë i tregova se çfarë më kishin pyetur mua. Ai më tregoi
20 se çfarë e kishin pyetur atë dhe më pas po prisnim sesi do të
21 përfundonte ky gjyq. Ju kërkoi ndjesë, po, në fakt, e kanë
22 pyetur atë edhe lidhur me fotografitë, për fotografitë që
23 kishte marrë. Dhe e pyetën sesi ka mundësi që ai kishte
24 fotografi të Slobodan Miloseviçit, një fotografi të tijën me
25 Miloseviçin, po ai kishte një fotografi të tijën me z. Ibrahim

1 Rugova.

2 Dhe ishte i interesant, që e pyetën për njërin apo për
3 tjetrin. Dhe ai tha që "Po unë kam qenë gazetar dhe i kam bërë
4 këto fotografi. Këtë fotografi të Ibrahim Rugovës e kam bërë
5 në një konferencë shtypi". Dhe mbase ky ishte një aspekt
6 interesant lidhur me pyetjet që i kanë bërë atij.

7 Përndryshe, nuk ka patur gjë tjetër që të jetë kaq me
8 rëndësi të veçantë. Pak a shumë kjo ishte puna.

9 PY. Dhe para se të informonin që ishit dënuar, a ke marrë
10 pjesë në ndonjë gjykim lidhur me aktakuzën kundër teje?

11 PË. Jo. Thjesht këta njerëz erdhën dhe na njoftuan që e
12 kishin filluar procedurën penale kundër nesh. Kaq. Ne nuk kemi
13 qenë të pranishëm në asgjë. Pas pak kohe ata thjesht na
14 informuan që do të na lirnin. Por ne nuk kemi marrë pjesë në
15 asnjë vend. Nuk dinim që po bëhej ndonjë gjykim. Ne thjesht
16 jemi informuar lidhur me vendimin që kishin marrë. Kaq.

17 PY. A keni pyetur ju nëse do të mbahej ndonjë gjykim?

18 PË. Kur na informuan në ditën e pestë apo të gjashtë -- nëse
19 ngulni këmbë të më pyesni nëse ishte në ditën e pestë, të
20 gjashtë apo të shtatë, po në atë kohë ka ndodhur kur kanë
21 ardhë për të na informuar. Folëm për gjysëm ore për çështje
22 politike e kështu me radhë, më pyetën mua për shokët e mi në
23 Prishtinë, gjëra të parëndësishme. Megjithatë na informuan. Ne
24 pyetëm "A do të marrim pjesë apo jo?" Ne kemi bërë një pyetje
25 të ngjashme, kur do të fillonte ky gjyq, a do të ishim të

1 pranishëm e kështu me radhë dhe më thanë që gjyqi do të ishte
2 i drejtë dhe nuk do të kishte asnjë lloj shqetësimi. Dhe kaq
3 di lidhur me gjykimin deri në momentin kur na u tha që vendimi
4 ishte që ishim dënuar me 60 ditë burg.

5 PY. Dhe mesa dini ju, z. Dobricic a ka marrë pjesë në ndonjë
6 gjykim vetë?

7 PË. Jo. Ne kemi qenë së bashku. Kemi ndenjur së bashku për
8 rreth 30 ditë a më shumë. Ai nuk ka marrë pjesë në asgjë
9 tjetër. Dhe në qoftë se e ke fjalën për tre, katër apo pesë
10 ditët kur nuk kemi qenë së bashku, ai më ka thënë që jo. Ai
11 nuk e ka përmendur asnjë lloj gjyqi. Kemi diskutuar faktin që
12 na kishin akuzuar dhe që do të gjykohehim, por nuk kemi
13 diskutuar asnjëherë që ai të ketë marrë pjesë në ndonjë
14 aktivitet që mund të përshkruhet si gjyq. Përjashtim ishte
15 thjesht fakti kur kanë ardhur dhe na kanë informuar, siç e
16 thashë. Për sa i përket gjyqit ne s'kemi patur dijeni fare për
17 mbajtjen e një gjyqi.

18 PY. Përpara se t'ju njoftonin për masën e dënimit, a keni
19 pasur ndonjë avokat të caktuar?

20 PË. Nuk kemi patur mundësi për të biseduar me askënd. Ne kemi
21 qenë veçmas. Ishin roje të cilët na kanë sjellë ushqim, ujë,
22 cigare. Na nxirrnin jashtë për të shkuar për nevoja personale.
23 Dhe kaq. Nuk kemi patur as avokat, as kemi marrë pjesë në
24 ndonjë gjë që mund të quhet gjyq. Kemi parë ata njerëz që
25 thashë. Dhe më pas, në ditën e 14 a 15 të ndalimit të mbajtjes

1 në paraburgim, erdhën dhe na thanë që ishim dënuar. Disa prej
2 tyre e kam fjalën. Dhe megjithëse ishte e ndryshme çështja na
3 thanë që nuk ishim spiunë, që do të liroheshim së shpejti e
4 kështu me radhë.

5 Më vonë, ne filluam një grevë urie pasi donim të shkonim
6 në shtëpi sa më shpejt që të jetë e mundur, por nuk di se çka
7 ndodhur ndërkohë. Ditën e gjashtë apo të shtatë, na thanë që
8 do të mbahej një procedurë penale kundër nesh. Ndërkohë që në
9 ditën 14 a 15 na thanë që nuk ishim spiunë dhe do të na
10 lironin të shkonim në shtëpitë tona sa më shpejt që të jetë
11 mundur. Dhe kur nuk u liruar gjatë ditës, ne vendosëm të
12 fillojmë një protestë me grevë urie.

13 PY. A keni kërkuar ndonjëherë nëse do të kishit mundësi që të
14 bisedonit me ndonjë avokat?

15 PË. Jo, jo. Në mënyrë të posaçme jo. Siç e thashë, erdhën në
16 ditën e gjashtë apo të shtatë dhe më pas nuk kishte njeri me
17 të cilin mund të bisedoje. Ishin thjesht rojet që cilët nuk më
18 dukën personat kompetent për ta diskutuar këtë çështje. Na
19 thanë thjesht që gjyqi do të ishte i drejtë dhe kaq për sa u
20 përket gjyqit. Ne pritëm që të na thërrisnin që të merrnim
21 pjesë në gjyq, por nuk ndodhi një gjë e tillë.

22 E vetmja gjë që ka ndodhur për sa u përket gjyqit është
23 kur u liruar, duke na thënë që do të liroheshim. Se nuk ishim
24 më spiunë. Dhe do të lejoheshim të shkonim në shtëpitë tona.
25 Dhe e kuptuam që do të na lejonin të shkonim së shpejti. Dhe

1 ne menduam që do të na lironim gjatë së njëjtës ditë. Dhe nuk
2 na liruan deri në darkë dhe më pas ne filluam një grevë urie
3 dhe kaq.

4 PY. Me sa di ti, a ka patur mundësi për të biseduar me ndonjë
5 avokat z. Dobricic?

6 PË. Po e përsëris, jo, nuk më ka thënë që t'i kenë ofruar
7 atij ndonjë gjë të tillë. Nuk kam dijeni që Dobricic t'i ishte
8 ofruar mundësia e një avokati.

9 PY. Ju kanë dhënë ndonjëherë ndonjë dokument në të cilin të
10 përshkruheshin akuzat me të cilat jeni akuzuar?

11 PË. Nuk kemi pasur asnjë dokument të shkruar asnjëherë.

12 PY. Mesa dini ju, po z. Dobricic a ka marrë ndonjë dokument
13 të tillë?

14 PË. Jo.

15 PY. Z. Radosevic, a keni patur ndonjë mundësi për sa i përket
16 një gjyqi apo jo, a keni patur ndonjë mundësi që të dilni në
17 praninë apo përpara një gjykatësi?

18 PË. Jo.

19 PY. Po z. Dobricic, me sa dini ju?

20 PË. As ai jo.

21 PY. Dhe kur ju informuan juve dhe z. Dobricic që ju kishin
22 dënuar, a kërkuat që t'ju tregohet kopja e aktgjykimit?

23 PË. Jo, ne nuk na kanë dhënë asgjë as herën e parë, as herën
24 e dytë ose herën e tretë kur na thanë që ne ishim shpallur të
25 pafajshëm. Asnjë dokument nuk na është dhënë lidhur me ndonjë

1 vendim të marrë.

2 PY. E kuptoj që thoni që nuk keni dokumente të tilla, por
3 pyetja është a keni kërkuar një dokument të tillë?

4 PË. Po, unë e kërkoja. Dobricic ishte ngjitur me mua, kështu
5 mund të them që e kemi kërkuar këtë. Sidoqoftë, unë e kërkoja
6 një gjë të tillë më datën 14, ditën e 14 apo të 15, por nuk e
7 kam marrë një gjë të tillë. Unë kërkoja që të më tregonin
8 ndonjë letër apo dokument lidhur me këtë vendim. Dhe nuk ma ka
9 dhënë njeri. Nuk do të përsërisë këtu atë që ka thënë ky
10 person kur unë i kërkoja që të më jepte dokumentin.

11 Herën tjetër kur kam kërkuar këtë dokument ishte në ditën
12 20 apo të 21 kur ne ishim në Kleçkë, mesa mendoj, nuk po
13 pretendoj që ishte në Kleçkë. Por me sa kam dëgjuar më vonë
14 nga policia, mendoj që isha diku i mbajtur diku në Kleçkë. Nuk
15 po pretendoj që isha atje, por me sa di, kemi qenë të mbajtur
16 në Kleçkë.

17 Sidoqoftë, në atë kohë, disa persona erdhën dhe na thanë
18 që ishim dënuar me 60 ditë burg për shkak se kishim hyrë në
19 mënyrë të paligjshme në territorin e Kosovës dhe nuk kemi
20 patur shenjat identifikuese të shtypit në makinën tonë.

21 Unë e pyeta këtë person, të cilin e quajta Student, si
22 Studenti, personi i cili na mori në pyetje gjatë ditës së
23 pestë apo të gjashtë. Ky person erdhi ditën e 21 për të na
24 thënë atë që ju sapo ju tregova. Ai tha që ishim dënuar me 60
25 ditë burg. Unë kërkoja dokumentin e këtij vendimi, por nuk më

1 dhanë gjë. Ai tha që këto ishin kushte lufte, ishin të
2 ndryshme kushtet dhe se ata nuk ishin në gjendje që të
3 siguronin ushqime dhe rroba nga Kryqi i Kuq, që na i siguruan
4 kur ishim në Shalë.

5 Por as unë, as Dobricic nuk kemi marrë asnjë dokument me
6 shkrim, pra, ai thjesht na tha që ishim dënuar me 60 ditë
7 burg. Dhe ai shtoi, "Z. Radosevic, ti e di shumë mirë që nuk
8 do të mund të mbajmë për një kohë më të gjatë". I thashë "Po,
9 faleminderit. E kuptoj atë që po thoni. Mirupafshim". Ai më
10 pyeti "Nëse mund t'ju ndihmojmë në ndonjë mënyrë tjetër?" Unë
11 i thashë "Po, kemi ftohtë". Dhe ai ju drejtua një personi, një
12 si një farë komandanti, i cili tha që "Do t'ju japim disa
13 batanije". Na dhanë dy batanije dhe kaq. Nuk e kam parë më
14 këtë person.

15 Dhe askush nuk e ka përmendur ndonjë gjyq apo dënim apo
16 ndonjë gjë tjetër me përjashtim të ditës së 36 kur edhe na
17 është dhënë amnistia.

18 PY. Kur ju thanë që ishit dënuar, a ju thanë nëse kishit të
19 drejtën e apelimit apo si mund ta shfrytëzonit këtë të drejtë?

20 PË. Jo, jo. të them të vërtetën as nuk pyeta ose ta them ne
21 nuk pyetëm. Ne thamë 60 ditë në burg dhe po shkojmë në shtëpi,
22 dakord. Çështja e vetme ishte nëse 20 ditët që kishim kaluar
23 në Shalë, nëse këto ditë do të llogariteshin si pjesë e kësaj
24 mase dënimi dhe ata thanë po, kjo si në çdo vend tjetër normal
25 do të ndodhë një gjë e tillë.

1 Kështu që ne menduam që ishin 20 ditë dhe pastaj na
2 mbeteshin 40 ditë të tjera. Thamë "Dakord". Dhe ai pastaj na
3 tha "Ju e dini që nuk do të kaloni as 40 ditë". Dhe tha "A më
4 kuptoni?" Thashë "Po, e kuptoj". Dhe, në fakt, ashtu ndodhi.
5 Ne e kemi kuptuar shumë mirë njeri-tjetrin ne të dy.
6 PY. Faleminderit, z. Radosevic. Tani do t'ju kërkoj që t'i
7 hidhni një sy videos të lirit tuaj, një film të cilin jua
8 kanë treguar më përpara, është pjesë e deklaratës që është
9 pranuar si provë materiale dhe pastaj do t'ju bëj disa pyetje.

10 Z. BOYLE: [Përkthim] Sekretaria, ju lutem të vendosim në
11 ekran P00093, nuk duhet të tregohet publikisht. Dhe ta luajmë
12 videon nga 4:56 deri në, pra, nga minuti 4:56 deri në minutën
13 e 7.

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
15 këshillohen]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet që ta
17 dëgjojmë zërin apo jo? Duhet zëri apo jo, pasi në seancë
18 publike zëri dëgjohet.

19 Z. BOYLE: [Përkthim] Ju keni të drejtë, i nderuar
20 Gjykatës. Mund ta luajmë zërin dhe të kalojmë në seancë
21 private për ta bërë një gjë të tillë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretaria,
23 të kalojmë në seancë private.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] A ka ndonjë arsye, i nderuar
25 Gjykatës, se përse po kalojmë në seancë private për këtë

1 video?

2 Unë po pyes a ka ndonjë arsye të shprehur këtu se përse
3 po kalojmë në seancë private për të dëgjuar këtë video, për të
4 parë këtë video?

5 Z. BOYLE: [Përkthim] Kjo është një video e cila është
6 shënuar si konfidenciale. Dhe në qoftë se duhet të që të
7 dëgjojmë zërin, atëherë kjo duhet bërë në seancë private.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë besoj që videoja është një
9 filmim i lirimit të këtyre individëve. Dhe në qoftë se është
10 një gjë e tillë, atëherë do ta rishqyrtojmë çështjen e
11 konfidencialitetit të kësaj videoje. Nuk e kuptojmë arsyen se
12 përse është bërë konfidenciale. Ndoshta ka ndodhur për shkak
13 se dëshmitari që ka folur për këtë video është bërë në seancë
14 të mbyllur, pasi, në fakt, të gjithë dëshmitarët e janë
15 dëgjuar, pothuajse, të gjithë dëshmitarët janë dëgjuar në
16 seancë të mbyllur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila është
18 arsyeja se përse dëshironi që kjo të mbetet konfidenciale?

19 Z. BOYLE: [Përkthim] Pjesërisht për shkak të burimit të
20 këtij filmi, unë mund ta shpjegoj këtë në seancë private, nëse
21 dëshironi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa bërë
23 ndonjë vendim, do të kalojmë në seancë private për të vazhduar
24 diskutimin e kësaj çështjeje.

25 Znj. Sekretare, kalojmë në seancë private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Seancë private)
Pyetje nga z. Boyle

Faqe 28

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Seancë private)
Pyetje nga z. Boyle

Faqe 29

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne jemi gati
10 të vazhdojmë. A jeni gati juve?

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, në rregull.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
13 Prokuror.

14 Z. BOYLE: [Përkthim] Nuk e kam përmendur më parë, por
15 kemi siguruar transkriptin e kësaj videoje, kemi dorëzuar. Atë
16 që është për përkthyesit, në qoftë se ata kanë nevojë për këtë
17 që u duhet. Në qoftë se Sekretarja e Gjykatës ka mundësi që të
18 na lëshojë videon që përmendëm.

19 [Luhet videoincizimi]

20 "Siç e thashë, ky do të jetë hapi i parë dhe uroj që të
21 këtë hapa të tjerë në vijim. Tani mund të marrim ndoshta të
22 ndaluarit".

23 Z. BOYLE: [Përkthim]

24 PY. Z. Radosevic, a jeni në gjendje të identifikoni dy
25 individët, burrat, që i shohim që flasin në këtë videoklip,

1 njëri me xhaketë blu dhe tjetri xhaketë kamuflazh?

2 PË. Z. William Walker është ai që po flet. Është shefi i
3 OSBE-së. Ndërsa personi tjetër është Sokol Bashota, UÇK apo
4 komandant i UÇK-së apo i KLA. Siç doni ju? Për këtë e keni
5 fjalën, për këta dy më pyetët?

6 PY. Po, kjo ishte pyetja ime. A keni parë ndonjë imazh të z.
7 Bashota përpara ditës së lirimit tuaj?

8 PË. Bashota, Sokol Bashota. Kështu e ka emrin. Megjithatë po
9 e kam parë. Për shembull, më parë në mediat shqiptare ka dhënë
10 një deklaratë diku. Pra, pak a shumë e dija që ishte ai,
11 megjithëse kjo ishte rasti i parë që e pashë personalisht.
12 Përpara e njihja nga mediat. Paraqitej në media, në Koha,
13 Bujku, nuk jam i sigurt se cila. Por, thjesht, po, ishte
14 dikush që e njihja. Të tjerët nuk i njihja ose dukeshin. Këtë
15 e njihja. Tani, pse dhe si saktësisht, nuk e di, pak a shumë
16 nga mediat. E di që ka dhënë deklarata për media dhe për këtë
17 arsye e njihja.

18 PY. A e keni parë në vendin ku jeni liruar?

19 PË. Vetëm një çast, ju lutem. Personi tjetër aty, z. Walker,
20 ishte hera e parë që e shihja. Nuk e dija sesi dukej. Thashë
21 ta them edhe këtë ta theksoj.

22 PY. E vlerësoj këtë sqarim. A e patë z. Sokol Bashota në
23 vendin ku u liruat?

24 PË. Po, pra, e pashë këtu. E pashë aty.

25 PY. Pyetja ime ishte ditën e lirimit, ditën kur jeni liruar a

1 keni parë Sokol Bashotën?

2 PË. Po.

3 Z. BOYLE: [Përkthim] Nëse Sekretarja e Gjykatës mund të
4 lëshojë videon përpara pjesën tjetër bashkë me zërin.

5 [Luhet videoincizimi]

6 "Më lejoni t'ju pyes. Gazetarët këtu duan të bëjnë
7 pyetje. Po, po, do t'ju çojmë në Prishtinë, do t'ju kthejmë në
8 Prishtinë. Mos u shqetësoni për këtë. Pyetja ime është a
9 dëshironi t'u përgjigjeni pyetjeve të gazetarëve?

10 "Okej, në rregull. Vetëm dy, tre pyetje.

11 "Do ikim pastaj sapo të përgjigjeni.

12 "Kolegë, jemi të shkurtër sepse dëshirojmë të shohim
13 familjet tona dhe ju na kuptoni dhe, në fund të fundit, kjo
14 është historia jonë. Kolegu im më i moshuar mund të tregojë se
15 çfarë kemi përjetuar.

16 "Si ju kanë trajtuar?

17 "Na kanë trajtuar mirë. Kryesisht ka qenë korrekte që nga
18 fillimi, nga dita e parë, takimi i parë dhe pastaj vazhdimisht
19 deri në fund. Tani, kushtet e jetesës apo vendi ku kemi
20 qëndruar ka qenë siç ka qenë, varësisht nga kushtet, kemi
21 patur ushqim rregullisht.

22 "Cili është mesazhi juaj në këtë rast?

23 "Nuk e di në fakt se çfarë mesazhi mund të jepja. Nuk jam
24 politikan. Nuk kam ide.

25 "A ka ndonjë të burgosur tjetër në të dyja anët?

1 "Nuk e di. S'kam parë për të burgosur të tjerë në
2 asnjërën anë. Do të ishte normale që të lirohen e të shkonin
3 në shtëpi.

4 "Pse jeni arrestuar?

5 "Sepse më thanë që kisha hyrë në territorin e UÇK-së. Kjo
6 është arsyeja.

7 "Si ishte gjykimi?

8 "Nuk e di këtë. Ne thjesht na informuan që ishim shpallur
9 fajtorë.

10 "Dhe nuk e patë gjykatësin?

11 "Të paktën ai s'u prezantua tek ne. Okej, në rregull.
12 Besoj që është koha për ne të shkojmë në shtëpi.

13 "Faleminderit për kohën tuaj".

14 Z. BOYLE: [Përkthim]

15 PY. A i njohët individët që dolët nga makina?

16 PË. Po, është z. Dobrocic dhe unë vetë. Në rregull?

17 PY. Kur ju nxorën nga makina dhe ju vunë syzet. Gjatë kohës
18 që ishit të ndaluar a kishit syzet me vete?

19 PË. Jo, m'i kishin marrë që ditën e parë kur na ndaluan dhe
20 pastaj m'i kanë kthyer ditën e fundit. Ditën e fundit na kanë
21 kthyer gjithçka, dokumentet personale, syzet e të tjera,
22 përveç makinës. Të gjitha të tjerat na i kanë kthy, përveç
23 makinës. Dokumentet që patëm, paratë, gjithçka që kishim me
24 vete na u kthyen, përveç makinës.

25 PY. Në fund të videos, ka një shkëmbim me z. Dobricic, ku ai

1 pyetet pse s' ishte bërë gjykimi dhe ai përgjigjet:

2 "Për këtë nuk e di. Ne thjesht jemi informuar që ishim
3 shpallur fajtorë".

4 Ka qenë edhe përvoja juaj kjo, e njëjta gjë?

5 PË. Po, po përpiqem të sqaroj e të them këtë gjatë kohës
6 është. Tashmë e qartë është. Nuk kemi patur një gjykim. Të
7 paktë s' e kemi parë. Thjesht jemi informuar që ishim shpallur
8 fajtorë dhe dënuar me numrin e ditëve që u përmend më parë dhe
9 pastaj u falëm.

10 PY. T'ju pyes pak më shumë lidhur me z. Dobricic. Kur jeni
11 takuar me të për herë të parë?

12 PË. A mund të përgjigjem?

13 PY. Po.

14 PY. Kur filloi, kur ndodhi, kur filloi situata në Kosovë,
15 gazetarë, u dërguan gazetarë nga Beogradi në Prishtinë që të
16 raportnin, unë isha vetëm. Dobricic e kam takuar nga maji ose
17 qershori pak a shumë, por që ka qenë vera e 1998. Ai ikte e
18 vinte Prishtinë, Beograd. Nuk është se e ndiqja me shumë
19 vëmendje çfarë bënte. Ai është fotoreporter, unë isha
20 reporter, ndonjëherë ishim bashkë. Nuk ishim shumë të afërt me
21 njeri-tjetrin. Nuk shoqëroheshim. Më pëlqente a s' më pëlqente,
22 është diçka që s' kam pse komentoj sepse s' ka lidhje, s' është
23 me rëndësi.

24 Kaq mund të them unë për Dobricic. Nuk jemi shokë. Nuk
25 jemi të afërt. Thjesht rastisëm në të njëjtin vend. Punonim në

1 organizatë se na duhej të punonim. Kaq dhe natën e mirë, themi
2 ne në serbisht. Po mund t'ju them edhe njëherë që të afërt nuk
3 ishim.

4 PY. Z. Dobricic, a ju ka treguar ndonjë gjë lidhur me të
5 shkuarën e tij, përveç faktit që punonte si fotoreporter?

6 PË. Që ishte i martuar. Ka vdekur. Ka qenë i martuar. Ka
7 pasur një djalë që ishte po ashtu për një periudhë kohore
8 fotoreporter. Kishte një vajzë. Nuk di gjë për fëmijët. Vetëm
9 kaq di që ishe fotoreporter pranë Tanjug-ut. Nuk mund të them
10 asgjë më shumë. Asgjë nuk di për atë. S'kishim shumë gjëra të
11 përbashkëta. Nuk ishim të afërt. Nuk ishim as i njëjti brez, e
12 njëjta gjeneratë. Punonim bashkë kur lindte nevoja. Kishte
13 persona me të cilët punoja mirë. Kishte persona të tjerë që
14 s'më interesonin shumë. Thjesht duhet të punonim bashkë, kaq.
15 Nuk ishim të afërt. Më shumë flisnim për punën. Ti raporto, ti
16 bëj fotografi. Fare s'ishim të afërt. As nuk shoqëroheshim me
17 njëri-tjetrin.

18 Nëse doni të dinit për çfarë flisnim kur ishim bashkë,
19 për të gjitha gjërat flisnim: Si të pjekim kek, a do martohesh
20 kur të dalësh që këtu, çdo temë të mundshme. Na liruan. Dhe
21 pas lirimit një herë ose dy herë jemi takuar. Mesa di unë ai
22 nuk u kthye më të punonte. As nuk u kthye më në Kosovë. Nuk
23 punoj më për Tanjug-un, sepse unë shkova përsëri te Tanjug-u
24 më 20 janar të 1999.

25 Pra, ajo që po ju them është që nuk është dërguar më nga

1 Tanjug-u të punonte në Kosovë. A shkoi me dëshirën e vet më,
2 unë nuk e di. Herën e radhës që e kam parë ka qenë më duket se
3 në 2001 kur u riktheva dhe punova në Tanjug. Kaq
4 PY. Me sa dini ju, z. Dobricic ka qenë i përfshirë në
5 veprimtari spiunazhi gjatë kohës që ka qëndruar në Kosovë?
6 PË. Nuk e kam haberin fare. Nuk di më si ta them. Nuk gjë
7 fare. Asnjëherë s'fliste. As e ka zënë ndonjëherë në gojë. Nuk
8 e kam idenë fare me çfarë merrej. Unë di vetëm që ai ishte
9 fotoreporter pranë Tanjug-ut. Nuk ia kam haberin. Kështu themi
10 ne, nuk ia kam haberin. Ju thashë që nuk më pëlqente shumë,
11 njëmijë herë ua kam thënë që nuk më pëlqente.

12 Nuk kisha ndonjë kontakt të veçantë me të, përveç rasteve
13 kur duhet të bënim punën bashkë. Madje edhe kësaj here kur
14 shkuam në Kosovë, ne po prisnim Walker dhe misionin e tij të
15 vinin. Ata asnjëherë nuk erdhën. Dhe ne shkuam morëm një rrugë
16 tjetër se ai donte të bënte fotografi sepse kishte pasur disa
17 të shtëna disa ditë më përpara, para se të nënshkruhej
18 marrëveshja me Miloseviç.

19 Pra, ne devijuam rrugën se dikush i tha nga redaksia që
20 shko se ka ndodhur një gjë atje. Dhe ai tha, "Hajde shkojmë
21 nga kjo rruga se duhet të bëj disa fotografi".

22 PY. Më falni që ju ndërpreva, se këto i keni të gjitha në
23 deklaratën tuaj. Unë dua t'ju pyes po ju a keni qenë të
24 përfshirë në ndonjë veprimtari spiunazhi gjatë kohës në
25 Kosovë?

1 PË. Jo. Edhe e theksoj, jo.

2 PY. Muajt apo javët apo muajt pas lirimit tuaj a patët
3 ndonjëherë shansin të flisnit me ndonjë person nga ushtria
4 jugosllave që kishte informacion lidhur me ndalimi tuaj, nga
5 ushtria e popullit jugosllav?

6 PË. Po, e di. E di çfarë doni të dëgjoni ose çfarë doni që të
7 them. Në dhjetor apo janar të 1998 ose 1999, pra,
8 përkatësisht, dhjetori i 1998 janari i 1999, kur u lirova,
9 qëndrova për pak kohë në Prishtinë. Më pas, ish e dashura ime
10 dhe tashmë gruaja ime, udhëtuam, bëmë një udhëtim rreth
11 Serbisë. Po përpiqesha të pushoja pak. Kisha të afërm në Nish,
12 kështu që shkuam në Nish.

13 Nuk më kujtohet a ka qenë dhjetori apo janari. Isha me
14 një kushëririn tim Dusan Samardzic, më duket se aso kohe ishte
15 gjeneral me pozitë a kolonel, nuk e di saktë. Më duket se ka
16 qenë komandant i trupave të Prishtinës në atë kohë. Saktë nuk
17 e di çfarë pozite kishte, po e di që ishte në Shtabin e
18 Përgjithshëm. Në vitin 1990 ka qenë komandanti i garnizonit të
19 Prishtinës. E vizitova në Nish. Më tha: "Që ta dish, më bëhet
20 qejfi që je mirë, po dikush nga Shala ka qenë informator për
21 ne dhe shkante në Prishtinë, pra, shkante në Prishtinë herë
22 pas here. Shiste djathë në treg dhe ai më tha që ti ishe
23 shëndoshë e mirë". Por, herën tjetër, më tha: "Të tregoj pak
24 për Demaçin dhe për Thaçin. Demaçi i tha Thaçit 'Shiko, më
25 mirë t'i lirojmë këta gazetarët' se po na ushtrojnë shumë

1 trysni si nga ana e shtypit, po dhe të tjerë, nga burime të
2 tjera. Dhe Thaçi sipas asaj që tha Samardzic, iu përgjigj, më
3 tha 'Do t'i liroj kur të vendos unë për t'i liruar, jo kur të
4 më tregosh ti'".

5 Këtë kam dëgjuar, kaq mund t'ju them unë në lidhje me
6 këtë për këtë person. E kisha kushëri. Ishte me pozitë të
7 lartë, kështu që ai i dinte këto informacione, e dinte kaq gjë
8 për mua. Nëse më ka gënjyer s'e di, nuk e di pse do më
9 gënjente. Kaq më ka thënë dhe këtë po ju përcjell dhe unë.
10 PY. Pra, ai ju tha ju që kjo ishte një bisedë që z. Thaçi dhe
11 z. Demaçi e kishin pasur personalisht duke qenë fizikisht
12 pranë njeri-tjetrit apo kishin pasur këtë bisedë përmes një
13 thirrje telefonike apo në ndonjë formë tjetër, si kishte
14 ndodhur kjo bisedë?

15 PË. U përpoqa të isha i saktë. Është përgjim, është bërë
16 përgjim i një thirrjeje telefonike mes Thaçit dhe Demaçit, ku
17 Demaçi i ka thënë "Mbase duhet t'i lirojmë këta gazetarët
18 sepse kam shumë trysni nga shtypi dhe nga të tjerët në
19 Prishtinë". Dhe Thaçi iu përgjigj se do të na lironte kur të
20 vendoste ai dhe jo kur t'i thoshte Demaçi. Kështu që supozoj
21 kur ka thënë "përgjim", përgjim nënkupton përgjimi i një
22 thirrje telefonike. Çfarë përgjimi tjetër mund të ketë
23 PY. Faleminderit, z. Radosevic.

24 Z. BOYLE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam pyetje
25 shtesë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar].

3 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
5 çaktivizuar].

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I lutem, z. Kehoe të më
7 japë një moment.

8 Sot paradite, i dhashë numrin e provës materiale P492 një
9 prove materiale shoqëruese që kishte numrin U000-38554 deri në
10 U000-38690 në faqen U003-8645 deri në U003-8645. Kjo faqe
11 është pranuar më parë si prova materiale P378. Prandaj, me
12 lejen tuaj, do të doja që ky material tashmë të marrë numrin
13 P492 dhe të mbetet numri përfundimtar edhe për Prokurorinë sa
14 herë që lind nevoja për ta përdorur.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
16 E morëm parasysh korrigjimin.

17 Vazhdoni, z. Kehoe.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

20 Z. KEHOE: [Përkthim]

21 PY. Z. Radosevic, mirëmëngjes. Unë jam Gregory Kehoe. Jam
22 Avokat i presidentit Hashim Thaçi.

23 PË. Mirëmëngjes.

24 PY. Kam disa pyetje për ju. Nëse s'e kuptoni ndonjë prej
25 pyetjeve më thoni sepse do ta përsëris. Nëse ju ndërpres gjatë

1 kohës që po jepni përgjigjen, po ju kërkoj ndjesë
2 paraprakisht. Thjesht më thoni që s'e keni mbaruar përgjigjen,
3 sepse sigurisht që ne duam që e gjithë dëshmia juaj të
4 pasqyrohet në procesverbal. Kështu që paraprakisht unë ju
5 kërkoj ndjesë sepse e bëj këtë gjë. Atëherë vazhdojmë.

6 Shoh dëshminë tuaj dhe deklaratën tuaj që keni lindur në
7 shtator të 1966, saktë?

8 PË. Po.

9 PY. Na tregoni pak për arsimin tuaj, zotëri. Na tregoni diçka
10 më shumë lidhur me arsimin tuaj?

11 PË. Kam mbaruar shkollën fillore dhe shkollën e mesme,
12 shkollën 8-vjeçare dhe të mesme në Prishtinë. Më falni, më
13 saktë, dy vitet e para të gjimnazit i kam bërë në Nish. Vitin
14 e tretë dhe vitin e katërt, vitin e maturës, kam qenë në
15 Prishtinë. Pastaj u regjistrova në Universitetin Bujqësor dhe
16 në Universitetin e Arteve, historinë e artit më saktë. Po nuk
17 u diplomova në asnjë prej lëndëve. Fillova punën kështu që s'i
18 mbarova dot studimet.

19 Ka dhënë mësim në disa shkolla mësues zëvendësues më
20 shumë. Edhe mamanë e kam pasur mësuese gjithë jetën. Kështu që
21 dhe unë punova si mësues. Kaq.

22 PY. Pra, mbaruat gjimnazin. Kur keni qenë 18 vjeç i bie. Dhe
23 si rregull është viti 1994, kështu?

24 PË. 1985.

25 PY. 1985.

1 PË. Po, 1985.

2 PY. Pastaj vendosët të shkonit në universitet dhe vendosët të
3 studionit për bujqësi, kështu?

4 PË. Saktë.

5 PY. Po nuk keni studiuar për gazetari?

6 PË. Jo.

7 PY. Pastaj i braktisët, hoqët dorë nga studimet tuaja
8 universitare, kështu?

9 PË. Nuk mund të them që hoqa dorë, sepse i vazhdova më vonë,
10 i rifillova më vonë, po dhe nuk i mbarova tamam. Kam dhënë
11 mësim si, kam qenë mësues historie deri në 1996.

12 PY. Po pasi ndërpretët studimin tuaj në universitet, ju kryet
13 shërbimin ushtarak në Bosnje-Hercegovinë, a është e saktë kjo?

14 PË. Në 1986 deri në 1987, ose 1985 deri 1986, kam shërbyer në
15 Visoko në Bosnje-Hercegovinë. Kur u ktheva, rifillova
16 studimet. Por nga viti 1990, 1991, fillova të jepja mësim si
17 mësues historie.

18 PY. Pra, ju thoni që ju përfunduat ushtrimin ushtarak,
19 përfunduat, po, ushtrinë dhe u kthyet në Kosovë dhe kur u
20 kthyet në Kosovë rifilluat universitetin, kështu?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Isha i regjistruar në universitet
23 më përpara. Pra, isha i regjistruar në universitet përpara se
24 të shërbeja në ushtri dhe në majin e vitit pasardhës u kyça në
25 ushtri për disa arsye personale. Dhe një vit më vonë u ktheva

1 dhe rifillova studimet në universitetin e bujqësisë. Pas kësaj
2 u kyça dhe në universitetin apo fakultetin e historisë.

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Dhe prapë e ndaluat shkollën në këtë periudhë, apo jo, i
5 ndërpretë studimet?

6 PË. I ndërpreva studimet kur fillova të punoja si gazetar.

7 PY. Po ju filluat të punonit si gazetar në vitin 1886, a
8 është e saktë kjo?

9 PË. Po, më duket se në -- besoj se në qershor. S'jam i sigurt
10 në 1996, më 16 ose 6, nuk më kujtohet.

11 PY. Por ama bëhet fjalë për vitin 1996, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Pra, ju diplomë universitare nuk kishe, as nuk kishit
14 studiuar gazetari, kishit studiuar për bujqësi dhe histori dhe
15 Tanjug-u të punësoi në vitin 1996 si reporter në Prishtinë,
16 saktë?

17 PË. Po.

18 PY. Në atë kohë, pra, në 1996, qershori i 1996, kur të
19 punësoi Tanjug-u ju keni qenë reporteri i vetëm i Tanjug-ut i
20 vendosur në Prishtinë, saktë?

21 PË. Djordje Jevtic, që më mori në punë u zhvendos në
22 Prishtinë, kishte një post zyrtar në komunë. Dhe kur u largua
23 ngela vetëm. E di që ju duket pak e çuditshme, po kështu
24 ishte.

25 PY. Pra, gjatë kohës që gjërat po nxeheshin në Kosovë, ju

1 keni qenë korrespondenti i vetëm për Tanjug-un në Prishtinë, a
2 është kjo e saktë?

3 PË. Po. Herë pas here vinin reporterë kur kishte situata të
4 jashtëzakonshme, por unë kam qenë pika e kryesore e kontakteve
5 dhe raportoja për çdo fushë.

6 PY. Pra, ju punësuan të raportonit për çdo gjë, por ama ju
7 s'kishit përvojë që të shkruanit artikuj, apo jo?

8 PË. Jo, nuk kisha, po mësova.

9 PY. Pra, mesa kuptoni ju, ata ju punësuan, pra, Tanjug-u si
10 reporteri i vetëm në Prishtinë në vend që të punësonin dikë që
11 të kishte përvojë në gazetari por dhe në shkrim?

12 PË. Pajtohem me këto që po thoni. Absolutisht.

13 PY. Tanjug-u ka qenë agjenci shtypi shtetërore, saktë?

14 PË. Po.

15 PY. Që do të thotë drejtori ishte emëruar nga qeveria e
16 Slobodan Miloseviçit, qeveria e atëhershme e Slobodan
17 Miloseviçit, kështu?

18 PË. Mbase po. Besoj se kështu është. Mendoj, madje unë s'jam
19 shumë i sigurt si funksionon. Po më duket se i emëron kuvendi.
20 Po, po ishte. Po keni të drejtë ishte agjenci shtetërore.

21 PY. Më falni, ju ndërpreva. Po flasim për tetorin e 1998,
22 drejtori i Tanjug-ut aso kohe ka qenë Zoran Jevdjevic, saktë?

23 PË. Jevdjevic. Jevdjevic, po.

24 PY. Do ju tregoj një provë materiale që ka numrin DHT0273 dhe
25 do ju tregoj konkretisht faqen DHT02674, ajo fatkeqësisht nuk

1 është me përkthim në serbisht, kështu që do më duhet ta lexoj.

2 Shohim është pjesë, është një fragment i një libri Mark
3 Thompson e ka shkruar. Që thotë "Mashtrimi i luftës ose media
4 në Slloveni, Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë". Në paragrafin
5 që fillon "Në gusht":

6 "Në gusht të 1996, Jovanovic zëvendësohet si drejtor nga
7 Zoran Jevdjevic, 'sepse ishte përkrahës i zjarhtë i
8 presidentit Miloseviç'".

9 A është -- më falni --

10 PË. Besoj se po.

11 PY. Pra, personi që filloi të drejtonte të udhëhiqte Tanjug-
12 un, shkurtimisht pasi u punësuar ju, ishte një përkrahës i
13 zjarhtë apo besnik i Slobodan Miloseviçit, e saktë?

14 PË. Po. Po.

15 PY. Kur punonit për Tanjug-un, pra, këtë agjenci shtetërore,
16 z. Jevdjevic ishte një nga mbështetësit më të zjarhtë të
17 Slobodan Miloseviçit, apo jo?

18 PË. Po, mund ta thuash dhe kështu. S'e dija. Ishte agjenci
19 mediatike, ishte agjenci shtetërore. Kështu që shteti emëron
20 drejtuesit.

21 PY. Kur filluan të përshkallëzohej situata në Kosovë në mes
22 të viteve 1990-1996, 1997, 1998 - a ndryshoi marrëdhënia juaj
23 me Tanjug-un?

24 PË. Unë kisha dhe detyra të tjera. Që ta bëj të qartë, njësoj
25 si më përpara, raportoja dhe për bujqësinë, sa shitej, si

1 ishin të korrurat, drithërat. Kishte persona që vinin nga
2 Beogradi, se kishte shumë punë dhe unë vetëm nuk e bëja dot.
3 Kështu që vinin persona nga Beogradi, si fotoreporterit
4 Dobricic. Vinin një, dy, tre persona, në varësi të rastit, por
5 gjithmonë vinte dikush të më ndihmonte se unë isha vetëm. Po
6 gjithmonë ka pasë të tjerë që punonin për Tanjug-un.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj falje përkthyesve se e
8 ndërpreva dhe patëm mbivendosje zërash.

9 PY. Kush ishin këta gazetarët e tjerë që vinin në Prishtinë?
10 Më jep ca emra. Kush ishin?

11 PË. Gazetarë, si unë. Vinin nga Beogradi, nga Nishi, nga
12 Krushevac, nga Novi Sad madje ndonjëherë. Më së paku 20
13 gazetarë kanë ardhur me radhë, pastaj varet sesi e kishin
14 radhën për të ardhur, kë caktonte Tanjug-u dhe sa qëndronin.
15 Pra, ka pasur një ekip gazetarësh. Nuk kam qenë vetëm.

16 PY. Po na jep ndonjë emër, na jep ndonjë emër të ndonjë
17 gazetari që të shohim çfarë pune kanë bërë në Prishtinë aso
18 kohe. Na jep ndonjë emër të ndonjë gazetari.

19 PY. Të jap unë disa emra, megjithëse nuk e di çfarë rëndësie ka
20 kjo gjë. Ju kërkoj falje. Madje po e bëj si pyetje. Nuk e di a
21 duhet t'i përfshijë edhe këta persona. Davor Lukac, për
22 shembull, gazetar i Tanjug-ut. Davor Lukac. Ka qenë gazetari
23 që vinte më shpesh. Dejan Muljkovic, po ashtu gazetar nga
24 Krushevac. S'më kujtohet ka qenë dhe një tjetër, po që s'më
25 kujtohet mbiemri. Nga Nishi ka pasur -- kanë kaluar 20 vite.

1 Këta më kujtohen. Vesna Pejcic ka qenë gazetare e Tanjug-ut.
2 Ka qenë një gazetar nga Novi Sadi, po s'më kujtohet emri. E
3 kam po s'po e them dot. Kur të më kujtohet. Nuk po më kujtohet
4 tani për momentin. Se kanë kaluar 20 vite.

5 PY. Në rregull. Davor Lukac, thatë që ky vinte gjithmonë?

6 PË. Davor Lukac është emri.

7 PY. Davor Lukac. Në rregull?

8 PË. [Nuk ka përkthim]

9 PY. A e dini ju që Davor Lukac kishte kontakte me shërbimin e
10 fshehtë serb dhe për punonte për ta, për shërbimin informativ
11 serb?

12 PË. S'e kam idenë fare për çfarë po flisni. Ne punonim. Ne
13 vazhduam madje të punonim për Tanjug-un deri nga 2004 ose
14 2005, ai kaloi tek Fontana pastaj. Sepse pati probleme me
15 drejtorin atje, kështu që pastaj shkoi në agjenci tjetër
16 mediatike.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Mendoj që erdhi momenti i pushimit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,
19 është momenti për të bërë pushimin e parë. Mos harroni nuk
20 duhet të flisni me askënd lidhur me përmbajtjen e dëshmisë
21 suaj, pra, mos harroni, nuk duhet të flisni me askënd lidhur
22 me dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Rishihemi në orën 11.30.

2 --- Pauza fillon në orën 11.01

3 --- Seanca rifillon në orën 11.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

5 Sekretare, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të futet dëshmitari,

7 Gjykatës, harrova që të paraqisja si provë materiale DHT002673

8 [sipas përkthimit] deri në 2674 që janë dy faqe nga libri i

9 Mark Thompson-it.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni

11 kundërshtime?

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk ka.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT062673

14 [sipas përkthimit] deri në 2674 pranohet si provë materiale.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do

16 të ketë numrin e provës 1D51.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

19 jemi gati që të fillojmë me pyetjet e z. Kehoe.

20 Z. KEHOE: [Përkthim]

21 PY. Z. Dëshmitar, shpresoj që të kesh pushuar pak dhe të kesh

22 pirë një kafe. Kam disa pyetje. Dhe njëherë t'i kthehemi

23 çështjes së punësimit tuaj nga Tanjug-u, kush të ka punësuar

24 nga Tanjug-u?

25 PË. [Flet në anglisht] Është interesante gjithë kjo ndodhi.

1 Mamaja dëgjoi në radio që -- kishte vende pune të hapura për
2 gazetarë në Tanjug, në atë kohë unë nuk isha i punësuar me
3 orar të plotë në shkollë në qershor dhe mamaja tha "Nesho,
4 djali im, ti je i zgjuar, ti lexon plot".

5 PY. Po më fal që ju ndërpres? Kush?

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, desha thjesht, i
7 nderuar Gjykatës, që të dëgjonte pyetjen.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëgjoni vetëm
9 pyetjen.

10 Z. KEHOE: [Përkthim]

11 PY. Kush të ka punësuar?

12 PË. Djordje Jevtic, që në atë kohë ishte shefi i zyrës së
13 korrespondentëve në Tanjug. Unë aplikova dhe kaq.

14 PY. Ku ishte zyra e Tanjug-ut në Prishtinë?

15 PË. Ishte përballë zyrës së universitetit. Nuk e di adresën e
16 saktë. Po ishte afër me Bankos. Në qendër të qytetit.

17 PY. Dhe sa larg Hotelit Grand?

18 PË. 200 metra.

19 PY. Dhe Media Center e Serbisë ishte po kështu e vendosur në
20 hotelin grand, apo jo?

21 PË. Po, e saktë. Ata ishin në katin e parë.

22 PY. A keni bashkëpunuar ju me Media Center serbe në Hotelin
23 Grand?

24 PË. Po, si gjithë gazetarët e tjerë, vendas dhe të huaj -- e
25 kam fjalën për këta gazetarë, gazetarë serbë, shqiptarë. Që të

1 gjithë kanë shkuar në Media Center në Hotelin Grand. Aty ishte
2 vendi ku mblidheshim.

3 PY. Gjatë kohës që keni qenë në Prishtinë, a e keni takuar
4 apo keni biseduar me Zoran Andjelkovic? Që ishte i Këshillit
5 Ekzekutiv të Kosovës. A e keni takuar?

6 PË. Unë mendoj që emri i saktë ishte Zoran Bakic Andjelkovic,
7 por ka qenë anëtar i Partisë Socialiste të Serbisë dhe personi
8 kryesor në Kosovë dhe si gazetar sigurisht që kam marrë pjesë
9 në konferencat e shtypit, dhe kam bërë raporte si gjithë të
10 tjerët. Kam bërë punën time, e kam njohur këtë person.

11 PY. Sa shpesh e keni takuar apo keni biseduar me z.
12 Andjelkovic?

13 PË. Sa herë ka patur konferenca shtypi, sa herë që ai është
14 shfaqur në ndonjë aktivitetet, inaugurimin e ndonjë ndërtese
15 apo kështu me radhë. Por nëse pyetja është nëse e kam pasur
16 shok, jo, ai ka qenë politikan, unë kam bërë punën time.

17 PY. A keni biseduar apo takuar Nikola Sainovic, që ka qenë
18 zëvendëskryeministër i Serbisë.

19 PË. Nuk besoj se ta kem parë ndonjëherë. Por, nuk kam ide
20 nëse e kam parë, në qoftë se ka ardhur në Prishtinë e ka
21 mbajtur ndonjë konferencë shtypi, por si përndryshe, jo. Nuk
22 më kujtohet që të kem patur ndonjë gjë, apo ndonjë gjë të
23 përbashkët me z. Sainovic. Në qoftë se më vonë, në qoftë se ka
24 ardhur kur s'ka qenë më në pushtet dhe ka mbajtur ndonjë
25 konferencë shtypi, mund të ketë ndodhur, por nuk e kam njohur

1 këtë njeri, s'kam patur numrin e telefonit e kështu me radhë.

2 PY. Po Sreten Lukic, shefin e policisë në Kosovë? A e ke
3 takuar ndonjëherë?

4 PË. Jo, nuk kam asnjë lidhje fare. S'e kam parë asnjëherë apo
5 dëgjuar atë në jetën time. Ndoshta e kam parë më vonë, por jo
6 atje.

7 PY. Pra, dëshmia jote është që nuk e ke takuar asnjëherë apo
8 nuk ke folur me z. Lukic, kështu është?

9 PË. Nuk më kujtohet që të kem patur kontakte me të atje. A e
10 kam takuar atë në Beograd në 10-15 vjet të shkuara, apo nëse
11 ka qenë ai në një konferencë shtypi, nuk e di, por nuk jam
12 shok i tij, nuk e njoh, nuk e kam numrin e tij të telefonit
13 dhe nuk është asgjë e rëndësishme që mund të them këtu.

14 PY. Një individ tjetër ka punuar bashkë me ju, Milovan
15 Drecun? E njeh këtë person?

16 PË. Milovan Drecun nuk ka punuar me mua. Ka punuar për radio
17 televizionin e Serbisë dhe e di, e njoh, atë si gazetar. Ai ka
18 qenë në Prishtinë. Kështu që kam bashkëpunuar me të më vonë.

19 PY. A ishte gazetar i radios?

20 PË. Radio Televizioni i Prishtinës, apo i Serbisë. RTB, Radio
21 Televizioni i Beogradit. Ai ka punuar për ta, ai ishte gazetar
22 televiziv, jo i radios.

23 PY. Milovan Drecun, a ishte pjesë e radhëve e policisë apo e
24 ushtrisë jugosllave në kohën kur ndodhnin masakrat në Kosovë?

25 PË. Ai ka raportuar nga Kosova. Nëse ka patur lidhje me ta

1 dhe ka udhëtuar me ta, unë nuk e di. Nuk mund ta di se çfarë
2 informacioni ka marrë ai, por që ka raportuar nga atje, që ka
3 raportuar nga fronti i luftës, po, këtë e ka bërë. Këto mund
4 të shihen në televizion, mund t'i kontrollosh kur të duash,
5 televizionet e tij, në përgjithësi ai ka qenë një gazetar
6 mjaft i njohur dhe në fakt ishte në televizion gjatë gjithë
7 kohës. E kam fjalën për emisionin kryesor të lajmeve për
8 Serbinë dhe këtu përfshiheshin dhe raportet për Kosovën.

9 A e njoh këtë njeri personalisht? Po.

10 PY. Një reporter apo gazetar i Tanjug-ut si puna juaj, a keni
11 qenë pjesë e radhëve të ushtrisë jugosllave, apo të policisë
12 kur janë sulmuar pozicionet e UÇK-së apo fshatrat?

13 PË. Një herë, ka ndodhur që disa nga ne, jo vetëm unë, na
14 dërguan në kufi me Shqipërinë në Qafën e Prushit, apo në Qafën
15 e Duhles, nuk e di se në cilën nga këto pika kufitare, një
16 herë kemi qenë në afërsi të Obiliqit ku ishte e dislokuar
17 ushtria dhe ne shkuam për të raportuar këtë. Dhe kjo ka ardhur
18 pas një ftese zyrtare që na ka bërë ushtria, nuk më ka dërguar
19 vetëm mua, por të gjithë përfaqësuesit e medias për të parë se
20 çfarë bënin ushtria atje. Si hajnë, çfarë hajnë, çfarë pinin,
21 si silleshin, çfarë po bënin, e kështu me radhë. Pra ne kemi
22 raportuar mbi mënyrën sesi e kalonin ditën trupat.

23 Atë ditë në afërsi të Obiliqit, nuk ka patur as të shtëna
24 për të cilat mund të shkruaja. Ata na kanë ftuar siç e bëjnë
25 dhe tani në kohën kur ka manovra apo stërvitje dhe kur ftohen

1 gazetarët për të marrë pjesë. Askush nga Tanjug-u nuk më ka
2 kërkuar që të bëj ndonjë raport lidhur me luftimet mes tyre
3 dhe UÇK-së, nuk kam patur asnjëherë këtë detyrë, dhe në fakt
4 nuk e kam dijeni që t'i ketë ndodhë ndonjë gjë e tillë nga
5 ndokush brenda Tanjug-ut.

6 PY. Askush nuk ka marrë ftesë, të tjerët, por të kujtohet që
7 në kohën e masakrës së Jasharit në mars 1998, gazetarët e parë
8 të cilët ishin të pranishëm në këtë vend ishin gazetarët e
9 Tanjug-ut, apo jo?

10 PË. Jo. Unë kam qenë atje në atë kohë, nuk di se kush tjetër
11 të ketë qenë atje nga Tanjug-u. Ishte në mars 1998 apo jo?

12 PY. Po, mars 1998.

13 PË. Unë nuk kam qenë atje dhe në fakt nuk kam dijeni që të
14 ketë pasur gazetarë të Tanjug-ut, nuk e di. Dhe dyshoj që të
15 kemi qenë të pranishëm.

16 PY. Z. Radosevic, në qoftë se Tanjug-u po raportonte lidhur
17 me sulmin mbi kompleksin e Jasharit në mars të vitit 1998
18 ndërkohë që ndodhte, kush do kishte qenë ky gazetar i Tanjug-
19 u, në qoftë se ky person nuk je ti?

20 PË. Unë nuk kam qenë. A kanë dërguar policia apo ushtria dikë
21 drejtpërdrejt nga Beogradi në zyrën e Tanjug-ut, nuk e di,
22 nuk kam patur informacion të tillë. Unë kam ditur atë që kanë
23 ditur edhe të tjerët, atë që kam lexuar në gazeta. Unë nuk kam
24 patur fare dijeni që ka patur një sulm mbi kompleksin e
25 shtëpisë së Jasharit. Nëse dikush, zyra jonë në Beograd ka

1 marrë informacion apo si e ka marrë këtë informacion, unë nuk
2 di. Ose nuk më ka njoftuar njeri. Nuk e di nëse unë kam qenë
3 kaq i rëndësishëm për ta marrë këtë informacion.

4 PY. Z. Radosevic, a po thoni që, po i tregoni këtë Trupi
5 Gjykues se masakra e Jasharit në mars të vitit 1998 që është
6 një nga ngjarjet më të mëdha në Kosovë, dhe e cila është
7 mbuluar nga Tanjug-u a po thoni që ti korrespondenti i vetëm i
8 Tanjug-ut në Prishtinë nuk e patur dijeni se kush nga
9 raporterët apo gazetarët e Tanjug-ut e ka mbuluar këtë? Kështu
10 vërtet po thoni në dëshminë tuaj?

11 PË. Ekzaktësisht, po, saktësisht po. Nuk kam dijeni nëse ata
12 kanë marrë informacion lidhur me, në zyrën kryesore të Tanjug-
13 ut në Beograd, dhe kush e ka dhënë këtë informacion nuk e di.

14 PY. Z. Radosevic, gjatë kohës që ishe në Prishtinë, a ke
15 takuar një individ me emrin, që njihet me emrin Legija? A ke
16 biseduar apo e ke takuar ti një person?

17 PË. Jo.

18 PY. A kishit njohuri mbi aktivitetet e tij në terren dhe mbi
19 sjelljen e trupave që komandonte ai dhe masakrën që kryenin? A
20 keni patur dijeni mbi këtë çështje?

21 PË. Jo.

22 PY. Në qoftë se Legija po bënte masakra në terren, ti si
23 korrespondent i vetëm në Prishtinë nuk keni patur dijeni me
24 këtë çështje apo jo?

25 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj sepse kjo pyetje është

1 bërë dhe ka marrë përgjigje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Thatë që keni shkuar në Grand Hotel ku ishte qendra e
5 Media Center. Kjo ishte edhe selia e Arkanit kur ishte aty,
6 apo jo? Kur ishte në Kosovë ai?

7 PË. Më vjen keq, por nuk e kuptoj këtë pyetje. A doni të më
8 thoni që Media Center ka shërbyer si seli e Arkanit?

9 PY. E dimë që Media Center ka qenë në Hotelin Grand, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Por Hoteli Grand ka qenë edhe selia e Arkanit kur ai
12 ndodhej në Kosovë, apo jo?

13 PË. Kur Arkani ka shërbyer si president i klubit të futbollit
14 të Prishtinës, po ai ka pasur selinë në Grand.

15 PY. Po gjatë luftës në Kosovë Arkani ndodhej në Hotelin Grand
16 në Prishtinë, apo jo?

17 PË. Nuk e di. Nuk e di. Ndoshta ka ardhur po s'di gjë

18 PY. Pra, si gazetar i Tanjug-ut që mbulon ngjarjet në
19 Prishtinë, ti nuk ke patur dijeni nëse gjatë luftës Arkani ka
20 qenë në Hotelin Grand apo jo?

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtojmë, kjo pyetje është bërë
22 dhe ka marrë përgjigje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Aprovohet ky.

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Ndryshojmë atëherë temën. Sheshelin, e keni takuar

1 Sheshelin kur ai ishte, ndodhej në Kosovë?

2 PË. Po, e kam parë Sheshelin. Mund të ketë qenë viti 1997 apo
3 1996, 1996 apo 1997 kur kanë zgjedhjet, kur ka filluar
4 Milutinoviç në 1997, apo jo? Atëherë e kam parë atë në selinë
5 e tij kur ka mbajtur edhe një konferencë shtypi në Prishtinë.
6 Dhe hera tjetër kur e kam parë atë ka qenë viti 2001, apo
7 2002, kur po punoja për Tanjug-u dhe kam mbuluar të gjitha
8 partitë politike përfshirë atë të Sheshelit. Dhe këto janë
9 rastet kur kam parë Sheshelin.

10 PY. Gjatë luftës, a e keni mbuluar vizitën me trupat e tij që
11 ka bërë në Kosovë Shesheli?

12 PË. Jo. Jo, nuk kam punuar lidhur me këtë çështje. Unë po ju
13 them që ka patur edhe gazetarë të tjerë të Tanjug-ut atje, nuk
14 më ka caktuar njeri këtë dhe nuk di për cilat njësi bëhet
15 fjalë.

16 PY. T'i kthehemi atëherë punës që keni bërë juve gjatë kësaj
17 periudhe kohore në vitin 1996, 1997, 1998, kur filluan të
18 ngrihen tensionet në Kosovë. Ndërkohë që ngriheshin tensionet
19 në Kosovë, dhe shtohesh dhuna, a ka ndryshuar karakteri i punës
20 që ke bërë në emër të Tanjug-ut?

21 PË. Po, është shtuar puna. Kam punuar si gjithmonë dhe kam
22 raportuar nga konferencat e shtypit që janë mbajtur gjatë
23 konfliktit në Media Center për politikanë të tjerë, me Zoran
24 Andjelkovic, Baki, që e përmendëm, pra ato që mbanin
25 konferenca shtypi. Unë e kam mbuluar këtë lloj informacioni.

1 Kam patur edhe pjesë tjetër të punës.

2 PY. Gjatë luftës, a jeni caktuar që të mbuloni një zonë të
3 caktuar, për shembull?

4 PË. Jo, nuk e kemi ndarë kështu punën.

5 PY. Po përpara luftës, a keni patur përvojë të raportoni si
6 gazetar nga një zonë lufte?

7 PË. Jo. Si mund të ndodhte një gjë e tillë? Jo, nuk kam
8 patur.

9 PY. Të shohim nëse e kuptoj. Ndërkohë që vazhdonte lufta --
10 është viti 1996, 1997, 1998. Ti ke lënë shkollën bujqësore,
11 nuk ke përvojë në të shkruar, dhe jeni caktuar si
12 korrespondent në Prishtinë pasi kishit lënë universitetin, pra
13 pikërisht në kohën kur ngriheshin tensionet në Kosovë. Kështu
14 është, e vërtetë është?

15 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtim, të nderuar Gjykatës.
16 Duhet të specifikojmë këtë pasi bëhet në vitin 1998, ka patur
17 përvojë si dëshmitar [sipas përkthimit] gaze --

18 Z. KEHOE: [Nuk ka përkthim]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, hidhet
20 poshtë ky kundërshtim.

21 Duhet t'i përgjigjeni pyetjes.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju lutem, a mund ta përsërisni
23 pyetjen?

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Po përpiqem që ta kuptoj dhe po ju tregoj se e kuptoj.

1 Gjatë kësaj periudhe, vitin 1996, 1997, 1998, ti ke shkuar në
2 Tanjug, pa përvojë pune, ishit larguar apo kishit lënë
3 shkollën bujqësore, dhe keni shkuar në, pastaj jeni caktuar si
4 korrespondent i Tanjug-ut në Prishtinë pasi kishit lënë
5 universitetin në kohën kur tensionet dhe dhuna rritej
6 gjithandej në Kosovë. Kështu është apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Ju në kohën që keni punuar për Tanjug-ut, ju ishit
9 punonjës i qeverisë së Serbisë, apo jo?

10 PË. Edhe mund ta thuash ashtu.

11 PY. Atëherë, të ecim përpara në kohë. Kur i keni dhënë
12 intervistën ZPS-së në vitin 2019, ishit i punësuar nga qeveria
13 serbe, dhe në fakt gjatë intervistës në këtë dhomë ka qenë i
14 pranishëm edhe një prokuror i Serbisë, apo jo?

15 PË. Po, ka qenë i pranishëm një prokuror serb. Ata më thirrën
16 për të dhënë dëshmi përpara këtij Trupi Gjykues, kësaj
17 Gjykate.

18 PY. Të vazhdojmë më tutje. Në profilin tuaj në LinkedIn ju
19 thoni që jeni gazetar i punësuar nga qeveria serbe dhe punoni
20 në shumë platforma të medias, kështu është?

21 PË. LinkedIn?

22 PY. Po, LinkedIn.

23 PË. Dhe çfarë shkruhet aty?

24 PY. Dhe thuhet që ju jeni gazetar që punoni për shumë media
25 dhe që jeni punësuar nga qeveria serbe, kështu është?

1 PË. S'kam ide se çfarë është shkruar në profilin tim në
2 LinkedIn, nuk kam ide. Mund ta kontrolloj këtë në telefonin
3 tim celular, por nuk e di kur. Flitet për gazetarë për shumë
4 platforma?

5 PY. A jeni gazetar që punoni për Kosovo Online?

6 PË. Po, po. Punoj për Kosovo Online.

7 PY. Kosovo Online financohet nga qeveria serbe, apo jo?

8 PË. Kështu thoni ju.

9 PY. A është e vërtetë?

10 PË. Nuk e di nëse është ngritur nga qeveria e Serbisë. Unë e
11 di se kush më ka kërkuar që të punoj atje, por nuk e di se
12 kush e ka themeluar. Nuk e di në fakt se kush është pronari i
13 Kosovo Online.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Të vendosim provën DHT02675 deri në
15 DHT02681. Dhe të shohim vetëm faqen e parë.

16 PY. Kjo është faqja kryesore e profilit tuaj në LinkedIn, z.
17 Radosevic, ku thuhet:

18 "Gazetar i shumë mediave.

19 "Nga mars 2019 deri në më tani..."

20 Edhe thotë, "Qeveria Federale". Asaj i paraprin periudha
21 kur keni shërbyer në Tanjug, një agjenci tjetër shtetërore. A
22 është e vërtetë, zotëri, që jeni një gazetar që punoni për
23 shumë media, dhe që punoni për qeverinë federale serbe? Po,
24 apo jo?

25 PË. Kështu thotë, "gazetar për shumë media", dakord. Le ta

1 pranojmë, po, unë punoj për qeverinë, por çfarë? Nuk e kuptoj?

2 PY. Po keni punuar për qeverinë që nga ---?

3 PË. Por unë nuk punoj për qeverinë. Nuk punoj për qeverinë
4 tashmë. Unë jam larguar nga Kosovo Online në vitin 2021. Unë
5 punoj për Studio B.

6 PY. Kur keni folur me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ju
7 ishit një i punësuar nga qeveria federale, apo jo?

8 PË. Kam punuar për Kosovo Online.

9 PY. Dhe siç thuhet --

10 PË. Dakord, okej, dakord.

11 PY. Keni punuar për Kosovo Online që është një qendër
12 informative për serbët që banojnë në veri të Kosovës, kështu
13 është?

14 PË. Jo vetëm për ata, por për të tërë Serbinë. Atë mund ta
15 lexojë kush të dojë, nuk është një qendër informative që është
16 për serbët që jetojnë në Kosovë e Metohi. Është portal. Ne
17 punojmë për të tërë. Dhe media në Prishtinë na shfrytëzon si
18 burim informacioni. Edhe media nga Prishtina, ne marrim
19 deklaratën i parë, i dytë, i tretë, i katërt, kush të
20 dëshirojë mund t'i marrë dhe t'i shfrytëzojë.

21 PY. Pra që ta përbyllim këtë, që nga qershori i 1996
22 afërsisht, me disa përjashtime të vogla në vitin -- pra që nga
23 qershori i 1996, deri në qershor 2021 ju keni qenë i punësuar
24 i qeverisë federale serbe, apo jo?

25 PË. Po, nëse kështu -- nëse kështu doni ta shprehni unë kam

1 punuar për qeverinë gjatë gjithë kohës. Nuk ka qenë gjithë
2 kohën federale, por qeveria e republikës.

3 PY. Kur folët me Prokurorin, ju kishit disa shqetësime lidhur
4 me kohën e paraqitjes tuaj sepse kishit, do të duhej, apo
5 kishit planifikuar, të bisedonit me presidentin Vuçiç, apo jo?

6 PË. Jo, nuk mund ta shpreh, nuk e di si e keni interpretuar
7 këtë në këtë mënyrë. Unë e kam mbuluar aktivitetin e
8 presidentit të Serbisë.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Referenca është 114682, 114683 në
10 paragrafin e tretë.

11 PY. Është një shënim i Zyrës së ZPS-së pas diskutimit që ka
12 patur me ju dhe ku u thatë lidhur me periudhën kur do të jepni
13 dëshmi. Kur thatë që është, "Të dukej sikur ishte një shaka që
14 DHSK-ja nuk është një gjykatë e vërtetë që ju donit, ZPS-ja ju
15 ka kërkuar të jepni dëshmi kundër kriminelëve të luftës, por
16 nuk ishte serioze". Ju keni nënvizuar që ishit "person serioz
17 me përgjegjësi serioze" dhe keni bërë të gjitha planet për të
18 udhëtuar në drejtim të DHSK-së.

19 "Ai shënoi si shembull sesi pjesë e përgjegjësisë së tij
20 serioze, ditën pasuese ai duhet të intervistonte presidentin e
21 Serbisë si pjesë e punës së tij si gazetar."

22 Është e vërtetë kjo, apo jo?

23 PË. Po, e vërtetë është. Jo për të bërë intervistë me të, por
24 për të mbuluar aktivitetin e tij në një pikë të caktuar. Por
25 kjo nuk ka rëndësi, a mund ta shpjegoni se për çfarë bëhet

1 fjalë?

2 PY. Unë po them që ju i keni thënë Prokurorit dhe këtë ata na
3 e kanë dërguar neve, këtë shënim pra, që ju ishit, kishit
4 planifikuar që të intervistonit presidentin e Serbisë si pjesë
5 e punës suaj si gazetar. Kështu është apo jo?

6 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtojmë, kjo pyetje është bërë
7 dhe ka marrë përgjigje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, jam
9 dakord dhe duhet të vijmë në pikën kur ju do duhet të tregoni
10 se cili është argumenti, cili është argumenti i qartë?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Do ta bëj këtë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua që ta
13 paraqisni këtë që tani.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Do ta bëj, por jo në praninë e
15 dëshmitarit, pasi duam të diskutojmë disa çështje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë
17 çështjesh bëhet fjalë?

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Janë disa çështje për të cilat ai po
19 fliste.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, por
21 bijini shkurt.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Dakord.

23 Z. KEHOE: [Përkthim]

24 PY. Mund të vazhdojmë më tej. Ju thoni që jeni takuar me z.
25 Dobricic një herë në, kur? Maj, prill -- prill, maj 1998?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe ju i keni thënë ZPS-së, 116028-116030, se vetëm keni
3 punuar me atë herë pas here?

4 PË. Po.

5 PY. Po ashtu i keni thënë ZPS-së që personi që mund të dijë
6 për aktivitetet e UÇK-së gjatë kësaj periudhe kohore në 1998,
7 ishit ju, a është kështu?

8 Z. BOYLE: [Përkthim] Nëse mund të na jepni referencën për
9 këtë?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] 070725 Pjesa 3, faqja 20, rreshtat
11 17-23, janë tre rreshtat e fundit -- që duhet të jetë rreshti
12 21, 22, 23.

13 PY. A është kështu zotëri?

14 PË. A mund ta përsërisni pyetjen, ju lutem, sepse s'jam i
15 sigurt se për çfarë po pyesni, nuk ju kam kuptuar fare.

16 PY. Më thuani çdo herë që nuk e kuptoni pyetjen dhe do ta
17 përsëris atë.

18 Pra, i keni thënë Prokurorit se gjatë kësaj periudhe
19 kohore kur UÇK-ja ishte aktive, se ju ishit personi që kishte
20 dijëni për aktivitetet e UÇK-së, a është kështu?

21 PË. Nuk e di çfarë do të thotë kjo saktësisht, kam patur disa
22 informacione për gazetarët e tjerë, për atë që UÇK-ja mund të
23 -- po bënte ndoshta, informacione që mund të mblidheshin për
24 konferenca për shtyp, por nuk kam qenë ekspert i UÇK-së. E kam
25 fjalën, dua të them në krahasim me Dobricic kam ditur më shumë

1 se ai, por nuk e kam të qartë saktësisht se për çfarë e keni
2 fjalën këtu.

3 PY. T'ju lexoj pyetjen dhe përgjigjen që i keni dhënë
4 Prokurorit.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Dokumenti 070725-TR-ET, Pjesa 3,
6 faqja 20, rreshti 17-23.

7 PY. Nuk e kam përkthimin në serbisht, por do ta lexoj. Pyetja
8 dhe kjo është nga ZPS-ja:

9 "Kush i ka udhëhequr zyrat e Tanjug-ut që kanë qenë të
10 pranishme në Kosovë dhe Metohi gjatë konfliktit, periudhës së
11 konfliktit? A ka pasur, emrat e gazetarëve, fotografëve në
12 qoftë se u kujtohen me të cilët keni punuar gjatë kësaj
13 periudhe kohore? Konkretisht kushdo që mund të ketë njohuri
14 për aktivitetet e UÇK-së gjatë kësaj periudhe kohore?

15 "PË. Unë kam qenë ai person."

16 Tani, a i keni thënë ZPS-së që -- në dhjetor, pra, të
17 2019, që personi që kishte njohuri për UÇK-në gjatë kësaj
18 periudhe kohore ishit ju?

19 PË. Po, kam ditur më shumë se disa nga personat që ishin në
20 Beograd. Në krahasim me ata, po.

21 PY. Na thatë që z. Dobricic erdhi në Kosovë rreth muajit maj,
22 atëherë kur e keni takuar dhe ju, maj 1999.

23 PË. Kështu ma merr mendja.

24 PY. Atë thuajeni ju. Kur jeni takuar me z. Dobricic? Nuk dua
25 që të hamendësoni.

1 PË. Nuk e di saktësisht kur. Si do të -- si ta di unë a ka
2 shkuar në maj apo në qershor, ka ardhur siç kanë ardhur të
3 tjerë para tij. Nuk e di.

4 PY. Dhe nuk po ju kërkoj datë të saktë, z. Radosevic. Nga
5 dëshmia juaj del se ka qenë rreth, përafërsisht, në maj apo
6 qershor, saktë?

7 PË. Po. Besoj që kështu ka qenë. Pranverë, apo verë, diçka e
8 tillë.

9 PY. Pra, Tanjug-u ka dërguar z. Dobricic nga Beogradi në
10 Prishtinë, pra a është kështu?

11 PË. Po, punonte në Beograd.

12 PY. Nuk kishte fotograf vendorë në Prishtinë që ishin të
13 disponueshëm për të mbuluar këtë që do mbulonit ju? Për sa i
14 përket luftës?

15 PË. Tanjug-u kishte reporterë fotografë të vetët. Nuk ka
16 arsye që të merrni në punë fotografë vendorë, kanë dërguar
17 reporterët e tyre për të mbuluar ngjarje të caktuara, qoftë
18 ndërkombëtare këto, apo në lidhje me Serbinë apo çdo lloj
19 ngjarje.

20 PY. Fakti është Tanjug-u ka dërguar me avion një gazetar nga
21 Beogradi për të mbuluar luftën bashkë me juve, apo jo?

22 PË. Kështu është, saktë. Në fakt unë ndihmova, kam dhënë një
23 ndihmë. Ata janë marrë me këtë më shumë, me këtë çështje. Unë
24 jam marr me atë që po ndodhte në Prishtinë kurse ata janë
25 përqendruar mbi këtë pikë sepse ndoshta kishin përvojë më

1 shumë, ishin më të moshuar. Kishin përvojë pune më të madhe, e
2 kështu.

3 PY. Por Tanjug-u ishin të qartë që do të dërgojnë, dhe
4 dërguan z. Dobricic, a ishte kështu?

5 PË. Dhe? Ata e kanë zgjedhur atë, unë s'kam të bëjë fare me
6 këtë punë.

7 PY. Z. Dobricic vetë, ju thatë që nuk -- sot në mëngjes në
8 faqen 39, rreshti 11 thatë që nuk e kishit qejf z. Dobricic,
9 s'keni pasë raporte të mira me të, a është kështu?

10 PË. Po, saktë, kështu është.

11 PY. E dinit nofkën e tij?

12 PË. Kica.

13 PY. Dhe na thatë sot në mëngjes se e keni takuar vetëm një
14 herë apo dy herë pasi jeni liruar, është kështu?

15 PË. Ndoshta dy herë, tre herë. Por në tërësi nuk e kemi, nuk
16 jemi shoqëruar dhe nuk jam marrë, s'më ka interesuar se çfarë
17 bënte apo çfarë s'bënte. Pra s'kam patur dijeni lidhur me
18 këtë.

19 PY. Kthehemi tek artikulli i Vice, pra, që është dokumenti i
20 shënuar P94, artikulli i datës 4 qershor 2018.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, prova 494. Prova
22 materiale 494. Kam versionin serbisht, në fakt. Është 11425
23 [sipas përkthimit] sipas 114289 dhe versioni anglisht dhe në
24 serbisht është 11475, 114289 në serbisht. Faqja të cilën
25 kërkoj është faqja 114287.

1 PY. Tani, nëse mund ta shikoni këtë faqe, zotëri, në
2 serbisht, dhe kuptoj është një përkthim i gabuar në versionin
3 anglisht.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Nga se më thanë përkthyesit serbë,
5 që nënvizuan tani.

6 PY. Pra ju i keni thënë mediumit Vice në këtë intervistë më 4
7 qershor 2018, faqja 114287, se:

8 "Tanjug-u më ka dhënë një pushim të shkurtër dhe kam
9 kaluar nja dy javë në Beograd me shokun tim Kica."

10 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtim, këtu në versionin
11 anglisht nuk është kjo.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Versioni anglisht është i gabuar.

13 PY. Përkthyesi serb thotë që ju i keni thënë këtij individ
14 se keni "kaluar dy javë në Beograd me kolegun tim Kica". A
15 shkruan kështu?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

17 Z. KEHOE: [Nuk ka përkthim]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull, e kuptoj, se po
20 lexoja. Nuk e kisha -- tani po më pyesni nëse jam takuar me
21 Kican. Ne kemi kaluar këto, këtë javë apo këto dy javë në
22 Kopaonik, në malet e Kopaonikut. Kaq. Pastaj s'e kam parë më.
23 Kemi qenë atje nja dy javë.

24 Nëse është kjo problem i madh, por s'e shoh ku është
25 problemi. Kemi qenë në Kopaonik një javë apo pak a shumë

1 kështu dhe aty i kam thënë mirupafshim. Pastaj e kam parë nja
2 dy herë kur jam kthyer në Tanjug, nuk po gënjej këtu. Kemi
3 qenë aty, vajza e tij njihte të dashurën time që pastaj u bë
4 gruaja ime, pastaj nuk jam shoqëruar shumë me të sepse unë
5 shkova për skijim, ai shkoi në shtëpi. S'kam pas ndonjë
6 vlerësim të madh të tij. E kam pa pastaj disa herë pas kësaj
7 ngjarje dhe kaq.

8 PY. Keni shkuar pushime bashkë?

9 PË. Po, kam shkuar dy javë me të. Na kanë dërguar së bashku
10 atje. Nuk zgjodha unë që të shkoja me të apo jo.

11 PY. A të detyroi kush që të takoheshe me z. Dobricic?

12 PË. Jo, jo. Askush s'më ka detyruar. Por na kanë lejuar të
13 shkojmë atje për dy javë pushime. Të qëndrojmë në hotel, JAT
14 Apartments, apartamentet JAT, në Kopaonik, dhe kaq.

15 PY. Pra keni shkuar pushime për dy javë, dy javë pushime me
16 familjen tuaj dhe z. Dobricic dhe familja e tij, a është
17 kështu?

18 PË. Po, saktë.

19 PY. Ku keni shku pushime?

20 PË. Në malet e Kopaonikut. Është një qendër turistike, në
21 mal.

22 PY. Pra keni qenë me Dobricic në Beograd dhe pastaj po ashtu
23 me Dobricic kur keni shkuar në këtë mal?

24 PË. Po, na dërguan atje, bashkë. Të dy së bashku. Unë erdha
25 në Beograd dhe të nesërmen ne të dyve na dërguan që të

1 pushojmë që të marrim veten nga gjithë ajo që kishim kaluar.

2 PY. Pra keni kaluar këto javë me të, jeni shoqëruar me të,
3 keni qenë bashkë në Beograd dhe në male, apo jo?

4 PË. Jo, nuk jam shoqëruar me të në Beograd. Dhe ndërsa atje
5 në mal jam shoqëruar sa më pak që kam mundur përveç rasteve
6 kur s'kisha tjetër zgjidhje kur hanim mëngjesin apo drekë. Nuk
7 ka qëndruar shumë me të kur ishim në mal. Kam qëndruar, kam
8 kaluar kohën me gruan time.

9 PY. Gjatë këtyre javëve atje në mal, me z. Dobricic, me
10 sigurisht që keni patur mundësinë ta njihnit z. Dobricic, të
11 bisedonit me të, apo jo?

12 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtim pyetjes. E bërë dhe
13 përgjigjja është dhënë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
15 kundërshtimi, mund t'i përgjigjeni pyetjes.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Kjo s'ka kuptim fare.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë nuk jam shoqëruar me të në një
19 mënyrë si shok i tij. Në fakt ai u largua nga Kopaoniku dy a
20 tre ditë para meje, unë qëndrova më gjatë me gruan time sepse
21 kishim edhe disa ditë shtesë në dispozicion. Pas kësaj kam
22 shkuar tek të afërmit e mi në Nish, e kam përmendur këtë.

23 Z. Dobricic është dikush me të cilin kam punuar për një
24 periudhë të caktuar sepse kështu ishin rrethanat. Thjesht
25 ndodhi kështu. Pastaj më thirrën në Beograd dhe më thanë "A do

1 që të shkosh nja dy javë në Kopaonik?" dhe unë shkova. Kjo
2 s'do të thotë që unë kam shkuar atje, jam ulur, kam ndejtur
3 gjithë ditën me z. Dobricic duke u shoqëruar me të. Po jua
4 them për të njëmijtën herë dhe po e ripërsëris: Nuk më
5 pëlqente, nuk kam dashur të shoqërohem me të dhe kam kaluar aq
6 kohë sa kam qenë i detyruar të kaloj me të, jo më shumë. I kam
7 thënë mirëmëngjes, mirë -- si jeni, mirëdita. Unë shkoja me
8 gruan time për të bërë ski, dhe kaq.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, kërkoj ndjesë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë më
12 tej tani, kalojmë këtë pikë.

13 Z. KEHOE: [Përkthim]

14 PY. Keni kaluar 45 ditë me z. Dobricic në terren deri në
15 momentin kur jeni arrestuar më 18 tetor, a është kështu? 45
16 ditë në terren me z. Dobricic, apo jo? Po ose jo?

17 PË. Jo.

18 PY. [Nuk ka përkthim]

19 PË. Nuk kam qenë me të çdo ditë, si do të mund të isha?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Më lejoni të shfaqim dokumentin që -
21 - me numrin 083812 deri në 083822 në 383813 që është deklarata
22 e dhënë nga tani i ndjeri z. Dobricic, gjykatësit hetues serb
23 në vitin 1999. Në qoftë se mund ta shfaqim këtë dokument në
24 ekran ju lutem. Besoj që është faqja në vijim kjo.

25 PY. Kjo është një intervistë e z. Dobricic përpara gjykatësit

1 hetues serb në vitin 1999. Dhe besoj që është e njëjta,
2 paragrafi i dytë:

3 "Kolegu im Nebojsa Radosevic dhe unë u dërguam në Kosovë
4 si reporterë për Tanjug-un në mes të vitit 1998, për të
5 raportuar nga aty mbi zhvillimet aktuale. Kaluam 45 ditë në
6 terren deri më 18 tetor 1998, dhe raportuam mbi ngjarjet e
7 ndryshme nga Gjakova, Peja, dhe Mitrovica."

8 Tani, kjo është deklaratë që z. Dobricic i ka dhënë
9 gjykatësit hetues në Beograd. A e vërtetë?

10 PË. Kjo nuk është shumë e ndershme nga ana e tij. Kjo nuk
11 është e vërtetë, s'ka të bëjë fare me realitetin. Unë nuk kam
12 qenë kurrë 45 ditë me Dobricic askund dhe në asnjë kohë. Nga
13 ajo që shkruhet këtu duket, del që paskam shkuar në të gjithë
14 Kosovën me të duke bërë raporte. E vetmja gjë që është e
15 vërtetë, është që e kisha takuar 30 ditë më parë, s'kemi
16 kaluar kaq shumë kohë bashkë. Ndoshta kemi qenë bashkë një
17 herë apo --

18 PY. Dobricic i ka thënë gjykatësit hetues që ju keni kaluar
19 45 ditë në terren, domethënë ju thoni që ai po e gënjen
20 gjykatësit hetues?

21 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtim. Dëshmitari nuk e njeh
22 z. Dobricic, kështu tha.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
24 riformuloni pyetjen ndoshta.

25 Z. KEHOE: [Përkthim]

1 PY. Z. Dobricic i tha gjykatësit hetues se kemi kaluar 45
2 ditë në terren, pra ti dhe ai, bashkë. A është e vërtetë kjo,
3 apo jo?

4 PË. Jo, nuk ka thënë të vërtetën këtu. Tani, edhe diçka
5 tjetër. Çfarë shkruan këtu:

6 "Kolegu im Nebojha Radosevic dhe unë si gazetarë të
7 Tanjug-ut u dërguam, na dërguan në Kosovë në mes të 1998
8 [sipas përkthimit]..."

9 Tani si mund të më dërgonte dikush në Kosovë ndërkohë që
10 unë isha tashmë në Kosovë, po jetoja aty? Kjo është tregues i
11 vërtetësisë së kësaj deklaratë. Si mund të dërgohesha unë në
12 Kosovë, ndërkohë që isha aty, jetoja në Kosovë?

13 PY. Pra, kur ai thotë që keni kaluar 45 ditë, kjo nuk është e
14 vërtetë?

15 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtim, pyetja është bërë,
16 përgjigjja është marrë.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk është e vërtetë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E more
19 përgjigjen.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

21 PY. A ju informuan juve që ZPS-ja kishte ndërmend që të
22 paraqiste deklaratën e z. Dobricic si dëshmi në këtë shqyrtim?

23 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtim. Nuk mund ta dijë
24 dëshmitari këto lloj përgjigje, këto lloj gjërash.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

1 Z. KEHOE: [Përkthim]

2 PY. Vazhdojmë më tej. Flasim për Gjakovën, a keni qenë në
3 Gjakovë ju dhe z. Dobricic?

4 PË. Në Gjakovë besoj kemi shkuar. Dhe mendoj që kemi shkuar
5 në rastin kur kemi shkuar të shohim liqenin e Gllogjanit.
6 Është në afërsi të Gjakovës. Është e mundur që kemi shkuar në
7 terren në disa nga këto vende. Por nuk kam qenë me të 45 ditë
8 rresht. Ndoshta ai ka patur në mendje kur ka folur që ai vetë
9 ka kaluar 45 ditë në tërësi atje në atë vend, por unë nuk kam
10 qenë me të vazhdimisht gjatë 45 ditëve.

11 Është e mundur që kemi shkuar në Gjakove kur kemi qenë në
12 Gllogjan. Mendoj, ma merr mendja që mund të ketë, është e
13 mundur, por kaq i saktë mund të jem. Jo më shumë.

14 PY. Keni shkuar në Gjakovë me z. Dobricic, a keni vozitur ju?

15 PË. Jo, nuk vozis unë.

16 PY. Ishte ai në timon?

17 PË. Mendoj që kishim me vete një që ishte, ai ishte reporter
18 nga Blic-i apo dikush tjetër. Kemi qenë katër vetë në makinë.
19 Ka qenë dikush tjetër me neve që ka drejtuar automjetin, ka
20 qenë një -- kemi qenë disa makina që po shkonim te ky liqeni
21 në Gllogjan. Edhe kanë qenë pesë, gjashtë, apo shtatë makina
22 me eskortë. Pra nuk kemi shkuar me makinën tonë dhe nuk ishte
23 ai shoferi.

24 PY. Sa kohë u duhej që të mbërrinit deri atje, nga Prishtina?

25 PË. Nuk e di fare sa larg është nga Prishtina, Prishtinë -

1 Gjakovë. Dy, dy orë e gjysmë ndoshta? Pak a shumë kështu. Nuk
2 e di. Mes dy, dy orë e gjysmë. Kemi qenë një varg makinash,
3 nuk e di sa kohë kemi bërë për të shkuar deri atje.

4 PY. Keni biseduar me z. Dobricic gjatë udhëtimit?

5 PË. Si mund ta di unë këtë gjë? S'ia kam idenë fare për çfarë
6 kam biseduar me z. Dobricic apo nëse kam folur me të fare.

7 PY. A keni qenë në Pejë bashkë me z. Dobricic? Në Pejë?

8 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet, thjesht s'më kujtohet.
9 Dhe në veçanti nuk më kujtohet të kem shkuar në Mitrovicë.

10 PY. Keni shkuar në Mitrovicë me z. Dobricic?

11 PË. Tani sapo e thashë që nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet të
12 kem shkuar në Mitrovicë në atë kohë, fare. Nuk është që s'dua
13 të më kujtohet, por thjesht nuk e di, nuk më kujtohet të kem
14 shkuar në Mitrovicë në atë periudhë kohore. Ju thashë ku kam
15 shkuar, kam qenë në Qafa e Prushit, në Qafë Duhle. Kam shku në
16 Rahovec [sipas përkthimit]. Këtë e di. Kemi shku në Rrafsh --
17 në Sharr një herë. Kryesisht kam mbuluar ngjarjet në
18 Prishtinë, jo ato që ndodhnin në vende të tjera.

19 PY. Kur keni udhëtuar me z. Dobricic në këto vendet e
20 ndryshme, keni qenë në një makinë, apo jo?

21 PË. Po pra, kështu thashë.

22 PY. Dhe keni patur mundësinë që të bisedoni me njëri-tjetrin,
23 të flisni me njëri-tjetrin gjatë kësaj kohe, apo jo?

24 PË. Tani, ma merr -- me siguri do të kemi biseduar me njëri-
25 tjetrin.

1 PY. Dhe keni ngrënë gjatë rrugës për të shkuar atje, bashkë,
2 pra keni ngrënë me z. Dobricic, apo jo?

3 PË. Disa herë kemi ngrënë, ndonjëherë tjetër jo.

4 PY. Fakti është, dhe -- keni patur kohë të mjaftueshme që të
5 bisedoni me z. Dobricic dhe të mësoni gjëra për z. Dobricic,
6 dhe kjo përpara datës 18 tetor, apo jo?

7 PË. A kam patur kohë? Po. Në qoftë se kjo ishte pyetja juaj.
8 Nëse kisha kohë, po kam patur kohë.

9 PY. Dhe gjatë këtyre bisedave të ndryshme, të shumta me z.
10 Dobricic keni kuptuar se z. Dobricic ishte nacionalist radikal
11 serb, dhe se kishte qenë në zona lufte si në Kroaci dhe
12 Bosnjë-Hercegovinë, apo jo?

13 PË. Jo.

14 PY. Pra, dëshmia juaj është që kjo temë nuk është biseduar
15 fare, asnjëherë?

16 Z. BOYLE: [Përkthim] Pyetje e bërë dhe përgjigje e marrë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,
18 dëshmitari mund t'i përgjigjeni pyetjes.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Pa përkthim]

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. E di që ka punuar për
21 Tanjug-un. E di që kishte shkuar në zona lufte të ndryshme,
22 por saktësisht nuk e di, s'ia kam idenë fare që ishte fanatik,
23 a radikal, nacionalist serb, as nuk e ka thënë, as nuk e kam -
24 - nuk është deklaruar i tillë. As unë s'e kam pyetur për këtë.
25 Nuk isha i interesuar për këtë. Unë e di që vetë nuk jam

1 nacionalist i madh dhe për rrjedhojë nuk e kam ngritur këtë
2 çështje me të. Nuk e kam biseduar këtë me të fare.

3 Tani, për sa i përket Dobricic dhe bindjeve të tij
4 politike s'e kuptoj se çfarë ka të bëjë kjo me mua. Me gjithë
5 mend që nuk arrij ta kuptoj.

6 Z. KEHOE: [Përkthim]

7 PY. [Nuk ka përkthim]

8 PË. Është problemi i tij, çështja e tij, bindjet e tija, kanë
9 të bëjnë me të. Unë s'e di çfarë ka qenë apo çfarë s'ka qenë.
10 Vazhdoni.

11 PY. Ju e dinit shumë mirë, fare mirë që z. Dobricic ishte
12 nacionalist serb, që ishte sjellur në Kosovë me mbulimin, pra,
13 si fotograf, si reporter me qëllim që të merrte informacione
14 mbi lëvizjet e UÇK-së në terren dhe ju keni qenë aty për ta
15 ndihmuar atë. A s'është kështu?

16 PË. Jo. Nuk është kështu.

17 PY. Pra, meqë ra fjala. Ju po dëgjoni çështje që kanë të
18 bëjnë me fjalën hyrëse në këtë lëndë, dhe jeni -- e dini që ka
19 informacione dhe prova që -- për përfshirjen e z. Dobricic në
20 krime lufte në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci, saktë?

21 PË. Nuk e di.

22 PY. Ju morët në telefon ZPS-në lidhur me këtë? Pasi patë atë
23 që Mbrojtja paraqiti në fjalën hyrëse, nuk e kontaktuat ZPS-
24 në? Thatë që ishit i zemëruar sepse kishit parë një program
25 rreth Thaçit dhe që do i dërgonit ZPS-së një pjesë, një imazh

1 të një filmimi, a nuk ju kujtohet kjo?

2 Mos shikoni Prokurorinë, mos shikoni këta, ka ndodhur
3 kështu apo jo?

4 PË. Jo, jo. Po shikoj, por nuk jam i sigurt se cila është
5 pyetja juaj për çfarë po më pyesni kur flisni për një imazh të
6 një pjese të marrë nga një filmim?

7 PY. Do t'ju lexoj tani komentet tuaja që keni dhënë ZPS-së.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe do lexoj nga 11748 [sipas
9 përkthimit] deri në 11748 [sipas përkthimit], 49.

10 PY. Ky është përkthyesi. Përkthyesi kërkoi që të flasë me ju
11 dhe personat, dhe përfaqësuesit e ZPS-së prezantohen dhe ju
12 deklaroni se ishte i zemëruar sepse kishte parë një program në
13 televizor rreth Thaçit dhe gjykimit të tij. Dhe deklaronte që
14 e kishte dërguar një fotografi të marrë pra nga një imazh dhe
15 që priste që ju ta thërrisnit për të biseduar lidhur me këtë.
16 Jeni shkëputur dhe pak më pas keni dërguar pas pak -- pak më
17 vonë keni dërguar këtë imazh, pra. Dhe këtë ka qenë imazh i
18 nxjerrun nga fjala hyrëse e Mbrojtjes. A keni bërë një gjë të
19 tillë?

20 PË. Më jepni një çast. Po, po, më kujtohet. Ka qenë në lajme
21 në televizion në Serbi, dhe mua më kujtohet që treguan një
22 pjesë, u shfaq një pjesë e aktakuzës dhe në atë pjesë të
23 aktakuzës flitej për dy gazetar të Tanjug-ut dhe thuhej të
24 arrestuar, ose të kidnapuar aty. Unë e regjistrova, ose më
25 saktë i bëra një fotografi pamjes dhe ua tregova për t'u thënë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 82

1 që aktakuza është publike. Tani e di për çfarë po flisni, tani
2 e kam të qartë.

3 PY. Ju u zemëruat sepse fjala, deklaratat hapëse, ishin
4 publike dhe aty u përmend edhe përfshirja e z. Dobricic në
5 krime lufte.

6 Z. BOYLE: [Përkthim] E kundërshtoj, asgjë nuk thuhet në
7 këtë deklaratë në lidhje me këtë.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Një pyetje bëra.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfundojeni
10 kundërshtimin.

11 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj bazën. Asgjë nuk flitet
12 për këtë temë në këtë dokument.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Thuhet se është i zemëruar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por nuk
16 thuhet pse është i zemëruar.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Po edhe unë prandaj po e pyes.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, jo, jo,
19 jo. Ju po ia thoni. Pyeteni.

20 Bëni pyetjen. Bëni pyetjen.

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 PY. A ishit ju i zemëruar për të gjitha këto provat që po
23 dilnin në lidhje me përfshirjen e z. Dobricic në krime lufte?

24 PË. Ku e kuptuat ju këtë? Ku e patë ju këtë gjë? Unë isha i
25 mllëfosur se radio dhe televizioni në Serbi po tregonin që dy

1 gazetarë ose më saktë shfaqën vetëm atë pjesë të aktakuzës ku
2 flitej për dy gazetarët. Nuk ka lidhje me asgjë tjetër. Unë
3 thjesht informova që jemi përmendur këtu në aktakuzë dhe kjo
4 po jepet publikisht në radio dhe në televizion.

5 Çfarë lidhje ka z. Dobricic me zemërimin tim?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I është
7 përgjigjur dy herë, vazhdoni me pyetjet e radhës.

8 Z. KEHOE: [Përkthim]

9 PY. Unë po ju them -- do flas për provat dhe bisedën që keni
10 pasur ju me z. Dobricic në cilësinë e tij si fotoreporter të
11 Tanjug-ut.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe për këtë qëllim do të kërkoja që
13 në ekran të shfaqej materiali DHT2025 deri në DHT2029, dhe
14 konkretisht më nevojitet faqja 2028 dhe 2029.

15 PY. Unë do t'jua lexoj se nuk janë në serbisht dhe pasi t'jua
16 lexoj do t'ju bëj disa pyetje.

17 I pari është një raport i Simo Rosic, është një raport që
18 jepen disa informacione shtesë. Ju kërkoj ndjesë, ky është një
19 raport nga një analist i ish-Tribunalit të Hagës, Ari, me
20 emrin Ari me mbiemër Kerkkanen. Ari Kerkkanen e ka përgatitur
21 raportin.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] 42 ju lutem. Në fund, këtu.

23 PY. Z. Kerkkanen ka shkruar një raport, pra, në ish-
24 Tribunalin e Hagës dhe ai citon një person me emrin Simo
25 Rosic. Thotë:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03880 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Page 84

1 "Një raport i Simo Rosic, me datë 11 mars 1992, jep
2 informacion të mëtutjeshëm. Sipas këtij informacioni grupi që
3 ka kryer vrasjet udhëhiqej nga komandanti i asaj kohe, Zoran
4 Tadic, dhe krahas tij janë kryer vrasje edhe nga vullnetarë
5 serbë, Kico (këtu është shkruar Kizo, por duhej të ishte
6 shkruar Kico), Pajser dhe Zoran Dondor. Në këtë raport Kico
7 është identifikuar si Kico Dobricic, gazetar i Tanjug-ut, dhe
8 një çetnik i zjarhtë, dhe anëtar i këtyre organizatave.

9 "Drejtorja e Shërbimit të Sigurisë Shtetëror në Benkovac,
10 në raportin e vet për Vladimir Dobricic, ndryshe Kico, jep më
11 shumë informacion lidhur me vrasjet që kanë ndodhur në
12 Skabrinjë. Raporti thotë që Vladimir Dobricic erdhi në tetor
13 bashkë me një grup vullnetarësh nga Serbia. Me vullnetarë të
14 tjerë, u bashkua Njësitit për Qëllimin Special në Shtabin e
15 Mbrojtjes Territoriale. Raporti thotë që për shkak të
16 aktiviteteve kriminale dhe të kryera që kanë ndodhur, ku afër
17 - ku u vranë me dhjetëra civilë, u vendos që njësiti të
18 mbyllej, dhe që grupi duhej të përjashtohej dhe të largohej
19 nga Benkovaci. Raporti përmend edhe Lulica Vucivecic [sipas
20 përkthimit] dhe Zoran Dondur që ndryshe janë ato pjesë e --
21 dhe vazhdon, Vladimir Dobricic, Ljubisa Vucicevic dhe Zoran
22 Dondur paraqiten në listëpagesat e Patrullës së Dytë të
23 Njësitit për Qëllime Speciale në nëntor 1991. Dobricic
24 rishfaqet në rajon në këtë zonë në mars 1992 ku përpiqej të
25 jepte furnizime apo ishte i përfshirë në furnizimet me armë

1 për serbët në Bosnjë.

2 Tani unë do të tregoj edhe një material tjetër, që është
3 po ashtu i sigurisë së brendshme serbe.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Me numër DHT0230 [sipas përkthimit]
5 DHT0243 [sipas përkthimit]. Anglishtja është faqja 2, dhe
6 serbishtja po ashtu në faqen...

7 PY. Thuhet kështu:

8 "Dobricic Vladimir, i njohur ndryshe si Kica, shfaqet në
9 këtë zonë në tetor të vitit të shkuar bashkë me një grup
10 vullnetarësh nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Dobricic
11 pretendon se është fotoreporter i Tanjug-ut dhe ka edhe një
12 kartë identifikimi. Sidoqoftë ka shprehur dëshirën për t'iu
13 kyçur Njësitit të Mbrojtjes Territoriale të Benkovacit si
14 vullnetar. Prandaj, bashkë me vullnetarët e tjerë, u kyç në
15 Njësitin për Qëllimin e Posaçëm, apo Qëllimin Special, të
16 Shtabit të Mbrojtjes Territoriale. Ky njësit ka marrë pjesë
17 pothuajse në të gjitha betejat që kanë ndodhur në këtë zonë.
18 Grupi i vullnetarëve pjesë e të cilit ishte Dobricic, ishin me
19 famë si kriminelë, njiheshin si kriminelë për një kohë të
20 shkurtër. Kriminelë që merrnin pjesë në beteja, kryenin
21 vjedhje, shpesh edhe vrasje. Krahas Dobricic, Vucicevic
22 Ljubisa, Dondur Zoran, një person me nofkën Jaro, nga Ilijas,
23 dhe persona të tjerë që emrat nuk ua dimë. Për shkak të
24 veprimtarive kriminale dhe vrasjeve që u ndodhën, veçanërisht
25 në Skabrinja -- për shkak të aktivitetëve, veprimtarive, të

1 tyre, pra u përjashtuan nga Benkovaci. Në atë kohë Shërbimi
2 kishte informacion se Dobricic dhe të tjerët u përfshinë në
3 rishitjen, pra rishitën, armët e sekuestruara, armët që vinin
4 nga burimet ushtarake, dhe mallrat që kishin plaçkitur. Me
5 kërkesën tonë, policia ushtarake e Shtabit të Mbrojtjes
6 Territoriale bastisi ambientet e hotelit ku jetonin personat
7 në fjalë, por nuk gjetën asgjë sipas raportit të tyre.”

8 Pra, pasi dëgjuat të gjitha këto, ju vazhdoni të thoni
9 dëshminë tuaj që z. Dobricic nuk ka thënë asnjëherë që ka qenë
10 luftëtar radikal i përfshirë në Kroaci, ishte përfshirë në
11 kontrabandën e armëve, dhe se ai ka vepruar gjithmonë nën
12 maskën e një fotoreporterit të Tanjug-ut? Pra po thoni ju që në
13 asnjë moment gjatë bisedave me z. Dobricic apo me të tjerë,
14 nuk ka dalë ky informacion?

15 Z. BOYLE: [Përkthim] A mund të na thoni periudhën kohore
16 për kur bëhet fjalë?

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Gjatë gjithë kohës.

18 Z. BOLICI: [Përkthim] Na jepni periudhën kohore, citimin
19 që bëtë në dokument.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Po them në çdo moment. Në çdo
21 moment.

22 PY. A e ka përmendur ndonjëherë Dobricic veprimtarinë e tij,
23 përfshirjen në Kroaci, përfshirjen në shitblerje armësh në
24 Bosnjë-Hercegovinë, vrasjet në Kosovë, në republikën e
25 Krajinës Serbe, pra çdo gjë, çdo gjë të mundshme, a e ka

1 përmendur ndonjëherë?

2 PË. Jo, pra. Ju thashë. Dukej i dyshimtë si person, mua m'u
3 duk person i dyshimtë dhe nuk më pëlqente.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Do ju pyes për një ngjarje tjetër ku
5 ka qenë i përfshirë z. Dobricic që ka qenë përfshirë dhe me
6 Seselj-in, ka qenë luftëtar bashkë me Sheshelin.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe për këtë do ju kërkoja
8 Sekretares së Gjykatës të nxirrte një raport të shërbimit
9 informativ, pra shërbimit informativ, organi i sigurisë. Ku
10 flitet, ku ka më shumë detaje për vrasjet në Skabrinjë në
11 Kroaci.

12 Z. BOYLE: [Përkthim] Po unë e kundërshtoj. Dëshmitari e
13 tha qartë që nuk di asgjë për këtë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

15 Z. KEHOE: [Përkthim]

16 PY. Në rregull atëherë. A e dini ju se -- djali i z.

17 Dobricic, Masha më duket se e ka pasur emrin, dini gjë në
18 lidhje me djalin e tij?

19 PË. Nuk ia di emrin. E di që ka qenë fotoreporter.

20 PY. Pra, edhe djali ka qenë fotoreporter?

21 PË. Të paktën kështu besoj.

22 PY. A e dini ju që dhe Masha ka luftuar në Kroaci nën
23 pretendimin apo nën maskën e një fotoreporteri?

24 PË. Mos e ekzagjeroni. Unë s'di gjë për këtë person, jo më të
25 di gjë për djalin. As nuk e kam idenë. Di që ka pasur një

1 djalë. Kur ishim me vajzën, dija që djali ishte fotoreporter
2 dhe u ka dhënë deklaratë ca gazetarëve, lidhur me çfarë kishte
3 thënë babai lidhur me mënyrën se si kishte përjetuar atë
4 periudhën kur kemi qenë të ndaluar nga UÇK-ja.

5 PY. Pra, ju thoni që ju dukej i dyshimtë, por sidoqoftë
6 vazhduat të punonit me të, kështu?

7 PË. Po, edhe çfarë?

8 PY. Pra, përgjigja në fakt është "po"?

9 PË. Po, sigurisht. Ai bëri punën e tij, ai bënte punën e tij,
10 unë bëja punën time. Kisha pesë, dhjetë vjet që e bëja këtë
11 punë.

12 PY. A ju ka thënë, ju e dini ku është Ilijasi? Diku jashtë,
13 diku afër Sarajevës? Ilijas. Në rrethinat e Sarajevës?

14 PË. E di që është një vend Ilijas diku në Bosnjë.

15 PY. A ju ka thënë që ka punuar me Sheshelin dhe grupin e
16 Sheshelit kur kanë vepruar jashtë Ilijasit, dini gjë për këtë?

17 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj, është bërë kjo pyetje
18 dhe është dhënë përgjigje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
20 përgjigjeni.

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 PY. Po apo jo? A ju ka thënë se ka qenë i përfshirë me
23 Sheshelin? Dhe se kanë vepruar jashtë Ilijasit? A ju ka thënë
24 këtë gjë?

25 PË. Jo, asgjë nuk ka thënë.

Dëshmitari: W03880 (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 89

1 PY. Pra, as për këtë nuk dini asgjë?

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Absolutisht jo.

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Ratko Mladic besoj se e dini ju kush është?

5 PË. Sigurisht që po.

6 PY. Atëherë më lejoni t'ju tregoj një faqe të ditarit të tij.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Është me numër DHT2270, deri në 2266
8 [sipas përkthimit] dhe faqja që na nevojitet është faqja numër
9 2390. Është një faqe nga ditari i tij i datës 24 mars 1992 në
10 prag të luftës, fillimit të luftës, në Bosnjë.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të ma jepni edhe
12 një herë numrin?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Më nevojitet faqja me numër 02390.
14 Edhe një herë, bëhet fjalë për faqen 2683-2684. Ju kërkoj
15 ndjesë, e kemi krijuar sot në mëngjes këtë fragmentin, pra e
16 kemi marrë në mëngjes fragmentin.

17 PY. Është një fragment nga ditari i Miloseviçit kur përmendet
18 dhe Vladimir Dobricic, ndryshe Kica, 46 vjeç, nga Benkovaci,
19 që është një nga udhëheqësit e kontrabandimit të armëve. Pra,
20 ju thoni që nuk dini asgjë për veprimtaritë e z. Dobricic në
21 përfshirjen e kontrabandimit të armëve?

22 Z. BOYLE: [Nuk ka përkthim]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, nuk është
25 Miloseviç, e kisha fjalën Mladiç.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
2 rëndësi nga kush ka ardhë ky informacion. Dëshmitari thotë që
3 nuk di asgjë lidhur me kontrabandimin.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj, ju lutem të kini durim.
5 Unë duhet që sidoqoftë t'ia them atij këto.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

7 Z. KEHOE: [Përkthim]

8 PY. Z. Radosevic, po ua them këtë informacion për z. Dobricic
9 se ju e dini shumë mirë që z. Dobricic ka qenë një ekstremist
10 nacionalist i dhunshëm. Ke ngrënë e ke pirë me të.

11 Z. BOYLE: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse kjo i është
12 parashtruar një herë dëshmitarit.

13 Z. KEHOE: [Nuk ka përkthim]

14 Z. BOYLE: [Nuk ka përkthim]

15 Z. KEHOE: [Nuk ka përkthim]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

17 Z. KEHOE: [Përkthim]

18 PY. Ju keni ngrënë e keni pirë me të, keni bërë pushime me
19 të, dhe pretendoni ju që kjo Gjykatë të besojë që ai s'e ka
20 bërë asnjëherë të qartë pikëpamjet e tij nacionaliste, apo për
21 faktin që ka qenë i përfshirë në dy luftëra të mëparshme? Nuk
22 doli kjo asnjë moment të vetëm? Këtë po thoni ju në dëshminë
23 tuaj? A është ky fakt?

24 PË. Fiks, kështu është, po.

25 PY. Unë po jua them kështu ama. Që ju dhe z. Dobricic keni

1 dalë atë ditë për të bërë fotografi për shërbimin informativ
2 serb dhe për të mbledhur informata për shërbimin informativ
3 serb, siç kishte bërë z. Dobricic në Kroaci, siç kishte bërë
4 në Bosnjë, ai po përdorte të dhënat e tij, po shfrytëzonte të
5 dhënat e tij si fotoreporter për Tanjug-un për të fshehur
6 identitetin e tij të vërtetë që ishte një luftëtar siç ishit
7 edhe ju. A nuk është kjo fakt?

8 PË. Jo, nuk është fakt. S'është e vërtetë. Të paktën jo për
9 mua. Sa për atë nuk më intereson.

10 PY. A e pranoni se kur po udhëtonit në zonën e UÇK-së në fakt
11 nuk kishit asnjë shenjë që t'ju identifikonte si pjesëtarë të
12 shtypit në automjetin tuaj, kështu?

13 PË. Vërtetë është.

14 PY. Po pse jo?

15 PË. Po ju po më thoni mua që çdo automjet i medias ka një
16 logo, apo një shenjë identifikuese në të?

17 PY. Jo, unë po ju pyes ju. Pse automjeti ku ishit ju dhe z.
18 Dobricic gjatë kohës që po udhëtonit në zonën e UÇK-së, pse
19 nuk kishit ju asnjë shenjë identifikuese në automjetin tuaj që
20 të identifikoheshit si anëtar të shtypit?

21 PË. Thjesht nuk e kishim. Dhe unë po e përsëris, jo çdo
22 automjet i shtypit ka domosdoshmërisht një shenjë në të.

23 PY. Ama, kur ju ndaloi UÇK-ja, ju u përpoqët ta fshihnit
24 identitetin tuaj, apo jo?

25 PË. Nuk është e vërtetë.

1 PY. [Nuk ka përkthim]

2 PË. U thamë, jemi gazetarë, ju treguam ato letërnjoftimet, ju
3 dhamë çdo gjë që na kërkuan.

4 PY. Ama, pajtoheni me mua që z. Dobricic nuk ia tregoi UÇK-së
5 veprimtarinë e tij në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë, pra
6 veprimtarinë e tij të mëparshme, apo jo?

7 PË. Shiko, gjatë kohës që unë isha me atë, unë nuk di t'u
8 ketë përmendur gjë. Nëse e ka bërë ato dhjetë ditë që ka qenë
9 [sipas përkthimit] me mua, unë nuk di të të them.

10 PY. Ama, fakt është se kur ndaluar, kur shkuat në pikën e
11 kontrollit, kur patë ushtarët e UÇK-së, kur u kthyet, ju i
12 thatë Dobricic të ikte me vrap, të vraponte, apo jo?

13 PË. I thashë të kthente makinën, automjetin, të ktheheshim
14 mbrapa. Ne kaluam përmes pikës së kontrollit dhe i thashë,
15 "Kthehu. Kthehemi më mirë. Ku do shkojmë?"

16 PY. Ama, në momentin që e kuptuat që do ballafaqoheshit me
17 ushtarë të UÇK-së, ju i thatë Dobricic të vraponte, apo jo?

18 PË. Të ktheheshim pas, po. Kjo është e vërtetë. Se ku të
19 shkonim? U bë e qartë që po vinim në territorin e tyre, pra po
20 vinim në territorin e UÇK-së. Dhe unë i thashë, "Kthehemi pas.
21 Çfarë do të ndodhë pastaj?"

22 PY. A nuk i thatë Dobricic kur shkuat pranë UÇK-së të
23 vraponte? Po ose jo?

24 PË. Jo. Ata ishin përballë nesh, ku të vraponim ne?

25 PY. Të tregoj një dokument që është intervistë e djalit të

1 Dobricic.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Është materiali me numër DHT02557
3 deri në DHT02671 dhe më intereson konkretisht faqja 267 --
4 [Mikrofoni çaktivizuar]. A mund të shkojmë në faqen 2670? Edhe
5 një tjetër, më duket se një faqe tjetër. Shkojmë pak më lart.
6 Pra te kjo faqja në fund, paragrafi i fundit.

7 PY. Ky është -- kjo është intervistë e djalit të z. Dobricic,
8 dhe ai vëren se:

9 "Gjatë kohës që është mbajtur i ndaluar, Vladimir
10 Dobricic kishte shumë fotografi me vete, ndër të tjera, të
11 Ibrahim Rugovës, Veton Surroit, por ama edhe një që gjithmonë
12 e mbante në portofol.

13 "- Ishte fotografi e Slobodan Miloseviçit dhe babai
14 mendoj se vetëm për shkak të kësaj fotografie kishin
15 mbijetuar, që nuk ka kuptim në fakt. Momentin që realizuan,
16 apo që kuptuan se ishin përballë ushtarëve të UÇK-së me maska,
17 Nebojsa bërtiti: "Vrapo", dhe babai ndaloi automjetin. Një
18 komandant që fliste serbisht u afrua dhe i tha, "Po të kishit
19 ikur dhe dy metra, do ju kishim gjuajtur dhe do ju kishim
20 vrarë."

21 A është fakt, pra që në momentin kur jeni afruar në pikën
22 e kontrollit të UÇK-së dhe patë ushtarët e UÇK-së, a nuk i
23 thatë ju z. Dobricic, "Vrapo"?

24 PË. Jo.

25 PY. Domethënë, s'është e vërtetë?

1 PË. Jo, nuk është e vërtetë. Në qoftë se ka dashur djali ta
2 nxjerrë babain si ndonjë hero, është çështje tjetër. Ama, kjo
3 nuk është e vërtetë. As nuk është zënë fare në gojë fjala
4 "vrapo". Një person na u afrua, na kërkoi letërnjoftimet,
5 kështu ka ndodhur.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Shohim një dokument të Prokurorisë
7 në lidhje me këtë, që ka numër P300, dhe ka datën 29 tetor me
8 titullin "Drejtoria e Policisë Ushtarake pranë Ushtrisë
9 Çlirimtare të Kosovës, Deklarata për Mediat numër 3". Prova
10 materiale P300.

11 PY. Thuhet:

12 "Të dielën, më 18 tetor të këtij viti rreth orës 15.00,
13 patrulla e Policisë Ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
14 afër fshatit Magurë ka hasur në veturën e tipit Yugo Florida
15 me regjistrimin të Beogradit, pa shenja të "Shtypit", me
16 shofer e bashkudhëtar, Vladimir Dobricic, Nebojsa Radosevic.
17 Pas dhënies së shenjës së ndalimit, ata janë ndaluar me vonesë,
18 duke u munduar pastaj ta fshehin identitetin e tyre. Kjo ka
19 bërë që të dyshohet lidhur me identitetin e tyre, duke mos
20 besuar se janë gazetarë dhe se qëllimi i ardhjes së tyre është
21 spiunazhi.

22 "Ata janë ndaluar e u është caktuar paraburgimi me qëllim
23 që të hetohet identiteti i tyre i vërtetë dhe qëllimi i
24 udhëtimit të tyre."

25 Ta marrim një për një. A është e saktë që ishit në një

1 automjet Yugo Florida pa shenja të shtypit në të? Po apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Thotë:

4 "Pas dhënies së shenjës së ndalimit, janë ndaluar me
5 vonesë..."

6 Pra, ju e pranoni që keni ecur dhe 500 metra pas pikës së
7 kontrollit, kaluat përmes, vazhduat dhe 500 metra pastaj
8 ndaluat dhe u kthyet në pikën e kontrollit, kështu?

9 PË. Po, kështu.

10 PY. Po pse u kthyet në pikën e kontrollit? Apo se patë që
11 kishit një pikë tjetër kontrolli përballë në rrugë? Apo jo?

12 PË. Nuk pamë pikë tjetër kontrolli në rrugë ne. Po ama për ne
13 ishte e qartë që thjesht po hynim, po avanconim më tej në
14 territorin e UÇK-së. Çfarë do bënim ne? Kështu që vendosëm që
15 thjesht të ktheheshim pas.

16 PY. [Nuk ka përkthim]

17 PË. Po ata personat thanë, "Ndaloni" dhe ne ndaluan.

18 PY. Shohim një shënim që e keni dhënë ju për Prokurorinë, një
19 shënim korrigjues.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe bëhet fjalë për provën materiale
21 numër P493, në qoftë se nuk e kam gabim. Faqja 2.

22 PY. Ju keni sqaruar se në vend të tetë a dhjetë anëtarëve të
23 UÇK-së në pikën e kontrollit, thatë që ishin rreth 15 deri në
24 20 në total, dhe tetë apo dhjetë të tjerë ishin në anën e
25 rrugës kur ju ndaluan, ndërsa anëtarët e tjerë të UÇK-së ishin

1 në një vend tjetër pak më lart në kodër. Kështu?

2 PË. Kështu.

3 PY. Domethënë, ju kaloni përmes pikës së kontrollit, por ama
4 shikoni që keni një grup tjetër me pjesëtarë të UÇK-së
5 përballë dhe kështu që vendosët të ktheheshit, apo jo?

6 PË. Jo. Ne kaluam pikën e parë të kontrollit, në të djathtë
7 këta personat. Vazhduam dhe 50 ose 100 metra më tej dhe ne u
8 kthyem sepse pamë që kishte një fshat dhe aty kuptuam që po
9 avanconim, apo po hynim në territor të UÇK-së dhe vendosëm të
10 ktheheshim pas.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Përfundoi koha, i nderuar Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
13 për sot përfunduat dëshminë tuaj. Duhet të ktheheni nesër në
14 orën 9.00. Mos harroni që nuk duhet të bisedoni me askënd
15 jashtë sallës së gjyqit për dëshminë tuaj. Tashmë Asistentja
16 do t'ju shoqërojë jashtë sallës.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kur të kalojmë në seancë publike
19 ka diçka që dua të parashtroj me ju në seancë publike.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Më duket se në seancë publike jemi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ah, jemi në seancë publike. E
23 qartë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

25 Z. KEHOE: [Nuk ka përkthim]

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk ka lidhje me këtë
2 dëshmitarin, por me dëshmitarin që më duket se do të dëshmojë
3 nesër. Apo kur të jetë planifikuar tani, për shkak të
4 ndryshimit.

5 Nuk e di nëse keni pasur mundësi të shihni Shënimin
6 përgatitor apo korrigjues të këtij dëshmitari, por ju lutem të
7 shihni Shënimin përgatitor numër 2. Në këtë Shënim përgatitor
8 është një përmbajtje apo më saktë një përshkrim i një -- është
9 bërë një përpjekje e dëshmitarit të negociojë diçka me
10 Prokurorinë para se të japë dëshminë. Është paragrafi 1 dhe
11 12. Diskutohet diçka lidhur me atë që është premtuar në të
12 shkuarën dhe çfarë nuk i është premtuar. Dhe ka një
13 kontradiktë të qartë mes asaj që është premtuar dhe z. Pace --
14 pra ka një kontradiktë mes asaj që ai pretendon që është
15 pretenduar dhe çfarë është pretenduar në të vërtetë sipas z.
16 Pace. Në thelb nuk është premtuar asgjë sipas këtij paragrafi.

17 Ama, kemi një situatë këtu. Dëshmitari ka shprehur
18 dëshirën të negociojë një përfitim, apo një paketë të caktuar.
19 Dhe nuk e di në qoftë se ju jeni të njohur me juridiksionin e
20 Shteteve të Bashkuara dhe të Mbretërisë së Bashkuar, por këtu
21 ngrihen pikëpyetje sa i takon sjelljes së përfaqësuesit të
22 Prokurorisë i cili në një farë mënyre i bën sugjestione apo
23 sugjeron dëshmitarit diçka në këmbim të të qenit dëshmitar i
24 mundshëm. Dhe në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA, pasi pamë
25 procedurën, kjo është krejt e papranueshme kur avokati i bën

1 një premtim dëshmitarit dhe vetë dëshmitari thotë që më
2 ke premtuar diçka dhe përfaqësuesi i Prokurorisë thotë që të
3 kam premtuar diçka tjetër.

4 Këtë po e them për procesverbal. Ju kërkoj të lutem, të
5 nderuar Gjykatës, të shihni 17 paragrafët e parë të këtij
6 Shënimi përgatitor, të shqyrtohet çfarë është ky premtim, ta
7 shihni këtë gjatë natës, dhe se çfarë pasojash ka kjo, sepse
8 kjo do të jetë një nga pjesët kryesore të kundërpyetjeve që do
9 të kem unë për këtë dëshmitar.

10 Dhe, pjesa tjetër, bëhet fjalë për paragrafët 13 deri në
11 17, ku për ne vërtet është shumë e vështirë. Dëshmitari, të
12 paktën dëshmitari [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] --

17 Z. BOYLE: [Përkthim] Më falni, por kjo duhet të jetë në
18 seancë të mbyllur.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, nuk është nevoja të jetë në
20 seancë private kjo. s'po jam asnjë të dhënë identifikuese për
21 dëshmitarin.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'e kemi as
23 ne të qartë. Më mirë të kalojmë në seancë private që ta
24 diskutojmë lirisht.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
5 seanca ndërpritet. Ritakohemi nesër në orën 9.00 të paradites.

6 --- Seanca mbyllet në orën 13.14

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25